



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në  
“Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut” ofruar nga  
institucioni i arsimit të lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”,  
Durrës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Prof. Dr. Ingrid Shuli

2. Prof. Dr. Gentiana Sharku

Shtator / 2023

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**për programin e studimit Master i Shkencave në "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"**  
**ofruar nga institucioni i arsimit të lartë Universiteti "Aleksandër Moisiu",**  
**Durrës**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Financë Kontabilitet
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.282, date 04.07.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	I dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 / 5
18	Numri i studentëve:	2022-2023: 10 studentë 2021-2022: 17 studentë 2020-2021: 12 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut”, është licensuar me urdhër të ministrit të arsimit, nr. 282 datë 04.07.2013. Ky program studimi është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë. Përshtatja e këtij programi studimi është miratuar me Vendim Senati Nr. 112, datë 14.06.2018 dhe miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin lartë me shkresën me Nr. Prot. 7243/1, datë 22.08.2018. Programi është riorganizuar deri në 20 % me Vendim Senati Nr. 34, datë 28.03.2022, konfirmuar nga MAS me shkresën Nr. Prot. 2085/1, datë 27.06.2022. Këto ndryshime kanë hyrë në fuqi në vitin akademik 2022-2023.

UAMD ka kryer procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit institucional të zhvilluar nga ASCAL dhe është akredituar në vitin 2016 për katër vite akademike dhe në vitin 2022 për herë të dytë me vendim të Bordit të Akreditimit nr. 18, datë 24.03.2022 me vlerësim pozitiv dhe kohëzgjatje 4 vite, me afat vlefshmërie deri në 23.03.2026.

Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Biznesit (FB), që përbëhet nga 5 njësi bazë:

- Departamenti i Financë-Kontabilitetit,
- Departamenti i Marketingut,
- Departamenti i Menaxhimit,
- Departamenti i Shkencave Ekonomike,
- Departamenti i Turizmit.

Departamenti i Financë-Kontabilitetit është njësi bazë përgjegjëse që mbulon këtë program studimi, i është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, në fushën financës dhe nënfushën e sigurimeve dhe menaxhimit të riskut.

Ky program studimi është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, i ndryshuar, sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale dy vite akademike (katër semestra), në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave në Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut”.

Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën e sigurimeve dhe drejtimit të rrezikut, të cilët do të jenë të aftë të përballen me sfidat kombëtare, por edhe ato globale të cilat direkt apo indirekt kanë impakt në ekonomi.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Në datën 24.01.2022, UAMD ka dorëzuar në ASCAL formularin e aplikimit, për nisjen e procesit të vlerësimit të programit të studimit. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017” ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Ingrid Shuli dhe Prof. Dr. Gentiana Sharku, pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, Msc. Erjon Xhako.

Në datën 15.05.2023, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe agjenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datën 21 Qershor 2023 në ambientet e UAMD. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 27.06.2023.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas fushave dhe për çdo kriter që i referohet standardit për këtë program e studimi. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë e pikave të forta dhe të dobëta të këtij programi studimi. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 29.08.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 15/140 Prot., datë 29.08.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 14.09.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 607 Prot., datë 08.09.2023, ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

**1. Lidhur me komentin e institucionit për standardin 2.3, konkluzione:**

Konkluzionet e GVJ për standardin 2.3 i referohen konstatimeve të bëra në kriterin 2 të Standardit 2.4. si më poshte:

*"Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se ka mospërputhje dhe paqartësi në raportim midis planeve mësimore të paraqitura në tabelat nr. 4 dhe nr. 10, si edhe syllabuseve të lëndëve:*

- Së pari, lënda "Ekonomiks Menaxherial" e cila sipas riorganizimit me shkresë të datës 12.02.2022 është zëvendësuar me lëndën "Ekometri" prezantohet sikur është zhvilluar në vitin akademik 2022-2023 (në syllabuset e lëndëve për vitin akademik 2022-2023, në tabelën nr. 10, por jo në tabelën nr 4).*
- Sipas planit mësimor të vitit 2021-2022 është zhvilluar lënda "Kontabilitet i Institucioneve financiare" e cila është e kategorisë "B", ndërsa në planin mësimor të vitit 2022-2023 është zhvilluar në të njëjtin semestër (Viti I, Sem. I) lënda "Sistem tatimor dhe doganor", e kategorise C me zgjedhje, ndërkohë lënda "Kontabilitet i institucioneve financiare" pavarësisht se është lëndë e detyrueshme nuk raportohet të jetë zhvilluar.*
- Lënda "Financa ndërkombëtare" e cila përfshihet në planet mësimore te tabelës nr. 4, nuk është përfshirë në planet mësimore të tabelës nr. 10. Për të dy vitet akademike (ne tabelen nr. 4), lënda "Financa Ndërkombëtare" prezantohet si lëndë me zgjedhje, ndërsa në syllabusin e saj i përket kategorizimit "lëndë e detyrueshme". Duke e konsideruar lëndën "Financa ndërkombëtare" si të detyrueshme, dhe meqenëse plani mësimor përmban 4 lëndë me zgjedhje (tabela 10), në vitin akademik 2021-2022 rezulton të jenë zhvilluar tre lëndë me zgjedhje (tabela 4). Nga ana tjetër ne tabelen nr. 9 "Financa Nderkombëtare është me zgjedhje" dhe nëse është e tillë në vitin 2022-2023 rezulton të jenë zhvilluar pesë lëndë me zgjedhje dhe jo 4 sikurse përcaktohet në planin mësimor të tabelës nr. 10."*

Komenti i institucionit i referohet në mënyrë specifike konstatimit të GVJ mbi lëndën "Ekonomiks menaxherial" dhe jo konstatimeve mbi lëndët e tjera. Tabela 4 e emërtuar "Ngarkesa totale e personelit akademik për programin e studimit ISDR" duhet të plotësohej për tre vite akademike dhe duhet të ishte emërtuar p.sh "Viti akademik 2022-2023" dhe jo "Plani mësimor 2022-2023". Duke marrë në konsideratë komentin e institucionit dhe duke konsideruar një lapsus emërtimin e tabelës, GVJ po heq komentin vetëm mbi lëndën "Ekonomiks Menaxherial" në pikën 3 të standartit 2.3, por nuk bën asnjë ndryshim në konkluzione.

Lidhur me komentin mbi ndryshimin e programit të studimit nën 20% për dy vite të njëpasnjëshme akademike, brenda një periudhe katër vjeçare pas riorganizimit të përgjithshëm të tij, GVJ mendon se është e shpeshtë.

**Raporti në këtë pikë ndryshon pjesërisht.**

**2. Lidhur me komentin e institucionit për standardin 2.4, konkluzione:**

Konkluzionet e GVJ për standardin 2.4 i referohen konstatimeve të bëra në kriterin 1 të Standardit 2.4.

Lidhur me mospërputhjen dhe paqartësinë në planet mësimore për lëndët me zgjedhje dhe të detyrueshme, GVJ është shprehur me hollësisht në standartin 2.3, kriteri 3.

Lidhur me kategorizimin e lëndëve sipas kategorive, GVJ mendon që është bërë në përputhje me kriteret e plotësimit të krediteve për cdo kategori, por pa patur parasysh përmbajtjen e lëndëve, sikurse është shprehur specifikisht në standardit 2.4, kriteri 1.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

3. Lidhur me komentin e institucionit për standardin 4.1, kriteri 2:

Ngarkesa totale e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ISDR duhet të paraqitet në tabelën nr.4 për tre vite akademike dhe duhet të përfshijë ngarkesën që realizon personeli akademik edhe për lëndët e tjera në të cilat angazhohet (përveç ISDR) (kjo është edhe një nga arsytet që GVJ kërkoi që tabelat të plotëoheshin saktë dhe të ridergoheshin edhe njëherë).

Edhe tabela 12 paraqet ngarkesën e tyre vetëm në këtë program studimi. Madje GVJ për të llogaritur ngarkesën që përballohet nga PAE dhe PAK ka patur vështirësi, sepse për disa lëndë ngarkesa është raportuar bashkarisht edhe për PAE dhe për PAK, ndërkohë që duhet të raportohet veçan për secilin pëdagog (jo për lëndë).

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

4. Lidhur me komentin e institucionit për standardin 4.3, konkluzione:

Konkluzioni i paraqitur nga GVJ bazohet në konstatimin që GVJ ka bërë në kriterin 2 të standardit 4.3 të cituar si më poshtë:

*"Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, GVJ konstaton se nuk ka informacion të përditësuar mbi pasurimin me tituj të rinj të viteve të fundit të bibliotekës, dhe në veçanti në lidhje me programin e studimit. Dokumenti i vënë në dispozicion të RVB mbi blerjet e librave për bibliotekën përmban të dhëna deri në vitin 2016 dhe për donacionet deri në vitin 2019. Përditësimi i literaturës nga institucioni është kryer nëpërmjet rregjistrimit në platforma elektronike".*

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

5. Lidhur me komentin e institucionit për standardin 4.4, kriteri 6:

GVJ i qëndron konstatimit se në shumë raste informacioni që prezantohet në faqen e internetit nuk është i aksesueshëm (del informacion tjetër që nuk ka lidhje me emërtimin përkatës).

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

6. Lidhur me komentin e institucionit për standardin 4.4, konkluzione:

Konkluzioni i paraqitur nga GVJ bazohet në konstatimin që GVJ ka bërë në kriterin 6 të standardit 4.4.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

7. Lidhur me komentin e institucionit për standardin 4.5, kriteri 2:

Komentet e GVJ në këtë kriter dhe për të gjithë RVJ bazohen në dokumentat e paraqitur nga institucioni, pavarësisht se mund të kenë gabime në emërtime. Pavarësisht se emërtimi i Evidencës nr. 117 është “Projekt buxheti 2021-2022 – Dep. FK”, tabelat brenda emërtohen si “Plan Buxheti për 2023-2025” të Fakultetit të Biznesit dhe janë të nënshkruara të gjitha vetëm nga Drejtuesi i Departamentit të Financë Kontabilitetit dhe nuk kuptohet nëse shifrat (si për shembull numri i studentëve që është shumë i lartë) i referohen departamentit apo fakultetit.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

8. Lidhur me komentin e institucionit për standardin 4.5, kriteri 5 dhe konkluzione:

Konkluzionet e paraqitura nga GVJ bazohet në konstatimet që GVJ ka bërë në kriteret 2, 3, 4 dhe 5 të standardit 4.5.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

**Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>UAMD, dokumenton se ofron programe studimi në përputhje e në shërbim të interesave kombëtare të vendit, duke zbatuar Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, kreu 1, neni 1. UAMD dhe ka në qendër të punës së tij respektimin e ruajtjen e vlerave akademike, kulturore e kombëtare, duke vënë në shërbim të këtij synimi kapacitetet njerëzore e intelektuale. UAMD synon arritjen e zhvillimin e një sistemi arsimor gjithë përfshirës, për të ofruar mundësi të barabarta për të gjithë pa dallime të asnjë lloji.</p> <p>Në Planin e Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të UAMD-së theksohet se programet e studimit kanë qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente.</p> <p>Ky program studimi është në përputhje me Ligjin “Për Arsimin e Lartë” 80/2015, Strategjinë Kombëtare të Arsimit, Statutin e UAMD, dhe gjithë bazën ligjore në fuqi. Ky program studimi u hap si nevojë e kohës dhe për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut për profesionistë në fushën e sigurimeve. Kompetencat e përftuara nga studentët do mundësojnë zgjidhje për problemet jetësore dhe do sjellin përfitime për universitetin, për rajonin e më gjerë. Përmes këtij program studimi kontribuohet në vlera të cilësisë, integritetit, besimit e respektit, të kërkimit shkencor, inovacionit e kreativitetit.</p> <p><i>Evidence 2_Statuti i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës</i>  <i>Evidence 3_Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës vitet 2016- 2020.</i>  <i>Evidencë 4_Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës vitet 2020-2025.</i>  <i>Evidence 6_Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026</i>  <i>Evidencë 10_Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale të UAMD.</i>  <i>Evidencë 11 _Plani Strategjik, Fakulteti i Biznesit, 2021-2025</i></p>



	<p><i>Evidencë 12_Plani strategjik Departamenti Financë-Kontabilitet, 2021-2025</i></p> <p><i>Evidencë 8_Draft Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë e Inovacionin, 2023-2030;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin e UAMD, me qëllimet e këtij universiteti, duke synuar arritjen e standarteve akademike bashkëkohore e ndërkombëtare, në përkrahje të aspiratave akademike dhe arritjet e gjithkujt që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë. Qëllimi i këtij programi studimi të ciklit të dytë me studentin në qendër, dokumentohet në Planin e Zhvillimit Strategjik të institucionit. UAMD dhe Fakulteti i Biznesit, pjesë e këtij universiteti synon nxitjen e zhvillimin e të menduarit kritik, ruajtjen e të dhënave personale, angazhimin ndaj studentëve e komunitetit. Kjo është e dokumentuar edhe në mendimin e Dekanit të fakultetit.</p> <p><i>Evidence 5_Mendimi i Dekanit</i></p> <p><i>Evidencë 8_Draft Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë e Inovacionin, 2023-2030;</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore program studimi Master Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut</i></p> <p><i>Evidence 10_Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Sipas dokumentave të UAMD, ky program studimi është hartuar në përputhje me strategjinë e UAMD. Në këtë dokument institucioni thekson rëndësinë e përmirësimit e rritjes së cilësisë së programit të studimit në zbatim të strategjisë së UAMD dhe referuar Planit të Zhvillimit Strategjik të UAMD.</p> <p>Sipas vizitës në institucion dhe shqyrtimin e dokumentave të institucionit, ky program studimi plotëson nevojat e kërkesat e tregut për profesionistë të tregut të sigurimeve dhe të manaxhimit të rreziqeve me të cilat përballet ky sektor, po kështu u krijon mundësi studentëve të thellohen në kërkimin shkencor. Ky program studimi ka në qendër formimin e specialistëve, ekspertëve për industrinë e sigurimeve dhe për sektorin e manaxhimit të rreziqeve, si dhe përgatitjen e studiuesve shkencorë për problemet me të cilat përballen institucionet mbikqyrëse të kësaj industrie, duke i pajisur me njohuritë e kualifikimet e duhura në përputhje me standartet ndërkombëtare për kërkimin e zhvillimin e tregut, me synim integrimin e industrisë së sigurimeve në parametrat e këtij sektori sipas BE.</p> <p><i>Evidencë 4_Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës vitet 2020-2025.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të UAMD, si në nivel institucioni edhe të njëjve përbërëse të tij. Planet strategjike, janë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, me interesin kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit, duke u</p>

mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>reflektuar në planet mësimore të programit të studimit, në programet e lëndëve, por edhe duke pasqyruar ndryshimet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, në përputhje me prirjet e tendencat ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidencë 4_Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit Aleksandër Moisiu" Durrës vitet 2020-2025.</i></p> <p><i>Evidencë 10_Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale të UAMD.</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore program studimi Master Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut</i></p> <p><i>Evidencë 3_Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit Aleksandër Moisiu" Durrës vitet 2016-2020</i></p> <p><i>Evidencë 11_Plani Strategjik, Fakulteti i Biznesit, 2021-2025</i></p> <p><i>Evidencë 12_Plani strategjik Departamenti Financë-Kontabilitet, 2021-2025</i></p> <p><i>Evidencë 8_Draft Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë e Inovacionin, 2023-2030;</i></p>						
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>UAMD e ofron programin e studimit në përputhje me misionin dhe qëllimin e deklaruar nga institucioni në Statutin e tij.</i></li> <li>- <i>Ky program studimi ofrohet në fushat e veprimtarisë së institucionit dhe ka si synim ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</i></li> <li>- <i>Programi i studimit paraqitet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe rregulloren e funksionimit të tij.</i></li> </ul>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="555 1214 762 1294">Përmbushet në tërësi</th> <th data-bbox="762 1214 954 1294">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="954 1214 1169 1294">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="555 1294 762 1328"></td> <td data-bbox="762 1294 954 1328"></td> <td data-bbox="954 1294 1169 1328" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet në tërësi	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			<b>X</b>
Përmbushet në tërësi	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		<b>X</b>					

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit i UAMD, zbaton Statutin e institucionit, neni 8, hartuar në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015 dhe zhvillon veprimtarinë në përputhje me misionin dhe objektivat e tij. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Financë Kontabilitetit, i cili ka në përbërjen e tij 16 anëtarë të kualifikuar, për fushat e financës dhe kontabilitetit, me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe nga personel akademik i departamenteve të tjera të Fakultetit të Biznesit. Dokumentohet kjo me CV-të e personelit akademik, si dhe nga dosjet e vetëvlerësimit. Departamenti i Financë Kontabilitetit ofron 7 programe studimi në të tre ciklet e studimit.</p> <p><i>Evidence 2_Statuti I Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës</i></p>

	<p><i>Evidence 16_Kualifikimi dhe kërkimi shkencor I PAE 5 vitet e fundit</i></p> <p><i>Evidence 17_CV të lectorëve, Programi Master I Shkencave Financë Kontabilitet</i></p> <p><i>Evidence 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lectorëve të Departamentit Financë Kontabilitet</i></p> <p><i>Evidence 17.1_CV të PAK, Programi Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut</i></p> <p><i>Evidence 22_Programet e studimit të ofruara nga Departamenti Financë Kontabilitet</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Dokumentohet nga institucioni se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore miratuar sipas vendimit 310, datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe udhëzimin nr 31, datë 15.11.2022, Nr.7556/1 Prot. “Mbi Procedurën për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, dhe me vendim për kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane nën emërtimin 72MS0412S.</p> <p><i>Evidence 23_Vendim nr 310, datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në RSH</i></p> <p><i>Evidence 24_Udhëzim nr 31, datë 15.11.2022, nr 7556/1 Prot. Mbi procedurat për e kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL në RSH</i></p> <p><i>Evidence 25_Kodifikimet e programeve të studimit në Departamentin Financë Kontabilitet</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit sipas fushave kërkimore të Departamentit Financë Kontabilitet.</p> <p><i>Evidence 26_Fushat kërkimore shkencore në Departamentin Financë Kontabilitet</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale</p>	<p>UAMD u jep mundësi studentëve të informohen për mundësitë e punësimit, për të kryer praktika mësimore, për trainime sipas</p>

të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel universiteti e fakulteti, si për shembull rasti i përmendur gjatë vizitës në UAMD - zbatimi i programit coursera, ku studentët e UAMD patën mundësi të marrin pjesë në një kurs pa pagesë. I gjithë informacioni promovohet në faqen zyrtare të internetit të UAMD, në rrjetet sociale të Departamentit të Financë-Kontabilitet dhe dërgimit të emaile-ve studentëve sipas programeve të studimit.</p> <p><i>Evidencë 163_Kurse online me Coursera_UAMD</i>  <i>Evidencë 37_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Univ.Aleksandër Moisiu Durrës dhe Fakultetit të Biznesit</i></p>		
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi i studimit është në përputhje me fushën e veprimtarisë së UAMD, të njësisë kryesore Fakultetit të Biznesit dhe të njësisë bazë, Departamentit të Financë Kontabilitetit.</li> <li>- UAMD angazhohet për ofrimin e trajnimeve gjatë të studentëve edhe pas diplomimit të tyre.</li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht
			<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në bazë të kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë, Statutit të UAMD (neni 51), Rregullores së Fakultetit të Biznesit (neni 24) dhe Rregullores së Departamentit të Financë Kontabilitet (neni 17) institucioni siguron marrëdhënie të përshtatshme bashkëpunimi, duke përcaktuar detyrat e personelit akademik dhe statusin e tyre. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik përcaktohen edhe në marrëveshjet e nënshkruara në fillim të vitit akademik mes drejtuesit të njësisë bazë dhe pedagogut lidhur me ngarkesën mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, kontribut institucional etj. Institucioni analizon në mënyrë të vazhdueshme punën, sipas detyrave të ngarkuara dhe realizimit të tyre nga ana e personelit të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore.</p> <p>Bazuar në nenin 10 të Rregullores për funksionimin e organizimit e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë, kreu V, në nenin 109 të Rregullores së UAMD, në nenin 24 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit, në kreun 4, neni 17 të Rregullores së Departamentit Financë Kontabilitet, janë përcaktuar detyrat e koordinatorëve të programit të studimit dhe të personelit akademik nëpërmjet marrjes së përgjegjësisë dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Ndarja e detyrave, ngarkesës mësimore</p>

	<p>brenda e jashtë auditorit bëhet në mbledhjet e njësisë bazë, në takimet mes grupeve të punës si edhe përmes postës elektronike. Analiza e vazhdueshme e punës së kryer vërtetohet përmes raporteve të analizës vjetore të aktivitetit akademik e atij kërkimor të Departamentit të Financë Kontabilitet, po kështu edhe përmes analizës së ecurisë së programit të studimit dhe dosjeve të vetëvlerësimit të punës akademike e kërkimore të çdo pedagogu.</p> <p><i>Evidence 1 Ligji 80/2015 Për Arsimin e lartë</i>  <i>Evidence 198_Njoftim punësimi për studentët</i>  <i>Evidencë 2_Statuti i UAMD</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë - Kontabilitet</i>  <i>Evidencë 29_Marrëveshje për organizimin e kohës vjetore të punës për stafin akademik të Departamentit Financë Kontabilitet viti akademik 2022-2023</i>  <i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Sipas dokumenteve shoqërues të RVB dhe vizitës në institucion, konstatohet se Departamenti i Financë Kontabilitetit në bashkëpunim me Fakultetin e Biznesit kanë nënshkruar marrëveshje reciproke me institucione të rëndësishme në vend si publike edhe private në nivel universiteti dhe fakulteti, për realizimin e objektivave kryesorë të procesit mësimor e formues të studentëve. Institucioni mundëson leksione të hapura nga lektorë apo përfaqësues nga biznese dhe institucione publike dhe private. Këto aktivitete janë në linjë me kërkesat e tregut dhe në përputhje me Strategjinë për Zhvillimin Kombëtar, duke përmirësuar edhe kurrikulat e programit të studimit. Qëllimi i këtyre bashkëpunimeve është pasurimi dhe përmirësimi i ofertës akademike dhe nxitja e kërkimit shkencor për të kontribuar në zhvillimin e ekonomisë së vendit.</p> <p><i>Evidencë 35_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit, me bizneset</i>  <i>Evidencë 36_Leksione të hapura dhe aktivitetet të Departamentit Financë Kontabilitet, 2021-2022</i>  <i>Evidencë 37_Trainime e mobilitete Erasmus+, PAE, 2017-2022</i>  <i>Evidencë 40_Abonim në librarinë digitale JSTOR në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD dhe AAF-së</i>  <i>Evidencë 41_Lista E-books e disponueshme</i>  <i>Evidencë 42_Informacion për bibliotekën on line</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,</p>	<p>UAMD ka nënshkruar marrëveshje me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës së sigurimeve, për realizimin e praktikave profesionale, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për realizimin e mbikqyrjen e praktikave profesionale të studentëve të këtij program studimi, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik e studentëve. Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua angazhimi i UAMD për të vazhduar bashkëpunimin në bazë të kërkesës së tregut dhe</p>

<p>praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>në përputhje me Strategjitë për Zhvillimin Kombëtar, duke përmirësuar edhe kurrikulat sipas nevojave të tregut.</p> <p>Programi i studimit i ka shfrytëzuar këto marrëveshje të bashkëpunimit për: të mësuarit përmes kryerjes së praktikave mësimore; për ofrimin e praktikave bashkëkohore e ndërkombëtare në fushën e sigurimeve dhe të rrezikut (duke kryer trainime/leksione të hapura/konkurse); për lidhjen e programit të studimit me tregun e punës, që është arritur përmes kryerjes së panairëve të punës (aktivitet vjetor); nxitjen e studenteve për t'u thelluar në kërkimet shkencore përmes aksesit të lirë dhe projekteve e konkurseve të përbashkëta; studimet e shkëmbimet afatshkurtra të studentëve e personelit akademik të mbështetura nga financimet e KE, përmes programeve Erasmus+; si dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në të cilat studenti është në qendër.</p> <p><i>Evidencë 37 Trainime e mobilitete Erasmus+, PAE, 2017-2022</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>UAMD e në mënyrë të veçantë njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione apo biznese, në funksion të realizimit të programit të studimit. Në zbatim të marrëveshjeve, interesi ka qenë reciprok, si nga ana e UAMD ashtu edhe nga ana e kompanive të sigurimit apo e institucioneve për të marrë pjesë në leksione të hapura në fakultet për studentët e këtij program studimi, duke ofruar internship për studentët, duke lejuar edhe zhvillimin e praktikave profesionale në institucione apo biznese, në zbatim të programit mësimor të lëndës/ve përkatëse. Studentët e këtij program studimi, kanë patur mundësi të marrin informacion, të kryejnë praktika mësimore, apo edhe të punësohen në këto kompani apo institucione. I gjithë ky proces bashkëpunimi ka qenë në qendër të analizave për përfitimet nga ky bashkëpunim.</p> <p><i>Evidencë 198 Njoftim punësimi për studentët</i>  <i>Evidencë 1 Ligji i Arsimit të Lartë e Kërkimit Shkencor në RSH Nr.80/2015</i>  <i>Evidencë 2 Statuti i UAMD</i>  <i>Evidencë 14 Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidencë 15 Rregullore e Departamentit Financë - Kontabilitet</i>  <i>Evidencë 29 Marrëveshje për organizimin e kohës vjetore të punës për stafin akademik të Departamentit Financë Kontabilitet viti akademik 2022-2023</i>  <i>Evidencë 30 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë</i>  <i>Evidencë 55 Aktivitete Fakulteti i Biznesit</i>  <i>Evidencë 200 Autorizim për praktikën mësimore Master</i>  <i>Evidencë 36 Leksione të hapura dhe aktivitete të Departamentit Financë Kontabilitet, 2021-2022</i>  <i>Evidencë 37 Trainime e mobilitete Erasmus+, PAE, 2017-2022</i></p>

	<p>Evidencë 40_Abonim në librianë digitale JSTOR në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD dhe AAF-së</p> <p>Evidencë 41_Lista E-books e disponueshme</p> <p>Evidencë 42_Informacion për bibliotekën on line</p> <p>Evidencë 43_Konkursi kombëtar i Punimeve Kërkimore</p> <p>Evidencë 94_Komunikim me email Njoftim mbi internship</p> <p>Evidencë 45_Analiza e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamentin Financë Kontabilitet, 2022-2023</p> <p>Evidencë 35_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit, me bizneset</p> <p>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR</p> <p>Evidencë 93_Analiza e tregut të punës MSc ISDR</p>		
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UAMD ka lidhur marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione akademiko-kërkimore në vend por edhe të huaja.</li> <li>- Institucioni ka lidhur marrëveshjeve të bashkëpunimit për realizimin e praktikave profesionale me biznese, institucione publike dhe private.</li> <li>- Në raportet vjetore të veprimtarisë mësimore dhe shkencore të UAMD, Fakultetit të Biznesit dhe Departamentit të financë Kontabilitetit analizohen marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit të angazhuar në këtë program studimi.</li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe	Organizimi i programit të studimit, është kryer në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018, pika 2, si dhe bazuar në riorganizimin e programit të studimit, pikat 4 e 6. Program i studimit organizohet në lëndë ose module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Totali i krediteve (ETCS) është 120

<p>me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>ETCS. Kohëzgjatja është 2 vite akademike, me katër semestra, forma e studimit me kohë të plotë, bazuar në suplementin e diplomës dhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 49_Riorganizim Master FB 2021-2022 Vendim Senati</i>  <i>Evidenca 49.1 Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023</i>  <i>Evidencë 49.2 Riorganizim Master nën 20%, 2021-2022</i>  <i>Evidenca 50 Udhëzim nr 31, datë 29.12.2017</i>  <i>Evidenca 51 Riorganizim I programit të studimit</i>  <i>Evidencë 9 Rregullore e program të studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit synon të realizojë formimin e shprehive të veçanta për shumë lloje profesionale dhe specialitetesh pasi ka kryer analizën e tregut të punës, e mbështetur kjo procedurë në rregulloren e riorganizimit të programit të studimit. Në programin e studimit që po akreditohet janë vendosur objektiva të qartë për lidhjen e studimeve të ciklit të dytë me studimet e mëtejshme, si ato doktorale. Synim i rëndësishëm për këtë program studimi është të rrisë kompetencat profesionale të studentëve. Këtij synimi i shërben edhe përmirësimi i syllabuseve të lëndëve, aktivitetet e ndryshme në shërbim të rritjes kompetencave profesionale, leksionet e hapura. Lektorët e këtij masteri sjellin në auditor metoda inovative për të aftësuar studentët.</p> <p>Në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të programit të studimit gjatë tre semestrave të studimit, studentët zhvillojnë lëndë bazë të detyrueshme, kombinuar me lëndët karakterizuese, dhe lëndë të tjera ndërdisiplinore dhe /ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje, ku i jepet rëndësi edhe lëndëve plotësuese. Në semestrin e katërt studentët realizojnë praktikën profesionale, të cilat zhvillohen tek subjekte publike e private, në përputhje me marrëveshjet e përbashkëta të nënshkruara nga Fakulteti dhe Departamenti Financë Kontabilitet për këtë element të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 93 Analiza e tregut të punës Msc ISDR</i>  <i>Evidenca 51 Riorganizim i programit të studimit MSc ISDR 2018-2019</i>  <i>Evidenca 55 Aktivitete Fakulteti I Biznesit.</i>  <i>Evidenca 66 Metodat interaktive të përdorura për mësimdhënien, shkurt 2023</i>  <i>Evidenca 45 Analiza e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamentin Financë-Kontabilitet, 2022-2023</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Sipas dokumentave nga institucioni dhe vizitës në UAMD, konstatohet se ky program studimi parashikon ngarkesën në kredite për praktikën profesionale të studentëve, sipas VKM 41, pika 2.4 dhe udhëzimit nr 31, datë 29.12.2017 për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të</p>



	<p>studimit nga IAL-të dhe mbështetur në planet mësimore dhe kurrikulat e ndryshuara në vitin akademik 2022-2023, të miratuara në department.</p> <p>Në planin mësimor të programit të studimit është përcaktuar qartë klasifikimi i lëndëve dhe vlerësimi i tyre me kredite sipas tipologjisë së përcaktuar në VKM nr.41:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kategoria A - Lëndë Bazë me 12 ECTS zënë rreth 10% të krediteve (i njëjtë me kufirin maksimal - 10% të krediteve);</li> <li>▪ Kategoria B - Lëndë Karakterizuese me 63 ECTS zënë rreth 52% të krediteve (brenda kufijve 50% - 60% të krediteve);</li> <li>▪ Kategoria C - Lëndë Ndërdisciplinore me 20 ECTS zënë rreth 17% të krediteve (brenda kufijve 12% - 20% të krediteve);</li> <li>▪ Kategoria D - Lëndë Plotësuese me 12 ECTS zënë rreth 10% të krediteve (i njëjtë me kufirin 10% të krediteve);</li> <li>▪ Kategoria E – Detyrime Përmbyllëse me 13 ECTS zë 11% të krediteve (brenda kufijve 10% - 15% të krediteve).</li> </ul> <p>Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese janë përlogaritur duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës.</p> <p>Nëntë lëndë zhvillohen me 75 orë në auditor, katër lëndë me 60 orë në auditorë, tre lëndë me 45 orë në auditor, ndërsa për praktikën dhe mikrotezën janë parashikuar 90 dhe 24 orë në auditor – në total për programin e studimit zhvillohen sipas planit mësimor 444 orë në auditor.</p> <p><i>Tabelat Master Shkencor ISDRpdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b>Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b>Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>

80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
<b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.
<b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Sipas komunikimit gjatë vizitës në institucion dhe sipas dokumentave të tyre rezultojnë se programi i studimit referuar emërtesës, nuk ka ngjashmëri në emërtesë me programe të tjera të ngjashme. Sipas kodifikimit të ri 72MS04 I 2S të bërë në vitin 2022, institucioni pohon se nuk ka informacion mbi kodifikimin e programeve të tjera të ngjashme të studimit.  <i>Evidencë 21_Kurrikula të ngjashme me IAL të tjera.</i> <i>Evidencë 25_Kodifikimet e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti Financë Kontabilitet</i>
<b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Dokumentohet se sipas VKM nr 310, datë 11.05.2022 mbi “specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me Udhëzimin 31, datë 15.11.2022, Nr.7556/1 Prot. “Mbi procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, fusha e përgjithëshme e specifikave të programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe shoqërohet me kodin përkatës 72MS0412S.  <i>Evidencë 25_Kodifikimet e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti Financë Kontabilitet</i>
<b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i>  - Programi i studimit është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënlige kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

	<p>- Nuk ka ngjashmëri në emërtesë me programe të tjera të ofriara nga IAL të tjera në vendin tonë.</p> <p>- Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>
			X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Dokumentohet se departamenti Financë Kontabilitet është përgjegjës për programin e studimit dhe i përmbush detyrimet ligjore e nënlige sipas nenit 25, të Ligjit për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” Nr. 80/2015.</p> <p>Fakulteti i Biznesit në UAMD, si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit ka angazhuar gjatë vitit 2022-2023 69 pedagogë efektivë, 69 pedagogë me kontratë dhe 15 personel ndihmës akademik. Fakulteti i biznesit përbëhet nga 5 njësi bazë (duke përmbushur përcaktimet ligjore përkatëse):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Financë-Kontabilitetit,</li> <li>• Departamenti i Marketingut,</li> <li>• Departamenti i Menaxhimit,</li> <li>• Departamenti i Shkencave Ekonomike,</li> <li>• Departamenti i Turizmit.</li> </ul> <p>Departamenti i Financë Kontabilitetit është njësi bazë përgjegjëse e programit të studimit. Ai funksionon dhe organizohet sipas akteve rregullatore të UAMD dhe në veçanti të rregullores së departamentit të Financë Kontabilitetit. Departamenti Financë Kontabilitet ka bërë ndarjen e grupeve mësimore kërkimore shkencore në Financë dhe Bankë, ka përcaktuar koordinorët e programit të studimit për secilin nga programet e studimit master që ofrohen nga ky departament, përfshirë edhe këtë program studimi, dhe koordinorin për kërkimin shkencor.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2020-2021, Departamenti i Financë Kontabilitetit ka angazhuar 50 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 17 PAE, nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 10 me gradën “Doktor”, 2 pedagogë në proces doktorature dhe 3 me Msc;</li> <li>• 33 PAK, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 3 me titullin “Profesor i Asociuar”, 7 me gradën “Doktor” dhe 21 me Msc.</li> </ul>

	<p>Gjatë vitit akademik 2021-2022, Departamenti i Financë Kontabilitetit ka angazhuar 49 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 17 PAE , nga të cilët 3 me titullin “Profesor”, 10 me gradën “Doktor”, dhe 5 pedagogë në proces doktorature;</li> <li>• 32 PAK, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 3 me titullin “Profesor i Asociuar”, 7 me gradën “Doktor” dhe 20 me Msc.</li> </ul> <p>Gjatë vitit akademik 2022-2023, Departamenti i Financë Kontabilitetit ka angazhuar 42 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 16 PAE , nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 9 me gradën “Doktor”, dhe 5 pedagogë në proces doktorature;</li> <li>• 26 PAK, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 5 me titullin “Profesor i Asociuar”, 5 me gradën “Doktor” dhe 14 me Msc.</li> </ul> <p>GVJ konstaton se numri i personelit akademik ka ardhur duke u ulur, kryesisht për shkak të angazhimit të një numri më të vogël të personelit PAK.</p> <p>Numri i personelit akademik që i përket kategorisë “Profesor” është i ulët dhe departamenti duhet të bëjë përpjekje për angazhimin e një numri më të madh pedagogësh nga kjo kategori.</p> <p><i>Evidencë 199_Ngritja e grupeve mësimore kërkimore dhe lektorët e Departamentit Financë Kontabilitet</i></p> <p><i>Evidencë 53_Vendim për emërimin e koordinatorit të programit të studimit</i></p> <p><i>Evidencë 56_Vendimi i përcaktimit të koordinatorit të kërkimit shkencor</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Dokumentohet se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, për realizimin e këtij programi angazhon personel ndihmës akademik e administrativ. Kjo në bazë të rregullores së Departamentit Financë Kontabilitet dhe në rregullorën e programit të studimit. Sipas këtyre dokumentave, krahas kooordinatorit të programit të studimit, njësia kryesore dhe njësia bazë mbështeten edhe tek personeli ndihmës akademik/administrative, përmes asistentes së Departamentit Financë Kontabilitet, sekretarisë mësimore dhe laborantëve të cilët janë të angazhuar në nivel njësie kryesore.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, Fakulteti i Biznesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• gjatë vitit 2020-2021 ka angazhuar 10 personel ndihmës akademik, nga të cilët dy janë angazhuar në Departamentin e financë Kontabilitetit;</li> <li>• gjatë vitit 2021-2022 ka angazhuar 15 personel ndihmës akademik, nga të cilët tre janë angazhuar në Departamentin e financë Kontabilitetit;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• gjatë vitit 2022-2023 ka angazhuar 15 personel ndihmës akademik, nga të cilët tre janë angazhuar në Departamentin e financë Kontabilitetit.</li> </ul> <p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidencë 56_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit</i></p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në bazë të dokumentave dhe sipas vizitës në institucion konfirmohet se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, në bazë të legjislaconit në fuqi ka caktuar me vendim të njësisë bazë koordinatorin e programit të studimit, i cili mban komunikim të vazhdueshëm me drejtuesin e njësisë bazë për informim të studentëve në lidhje me programin e studimit dhe praktikatat mësimore.</p> <p><i>Evidencë 49.1_Riorganizim master nen 20%, 2022-2023</i>  <i>Evidencë 78_VKM nr 824, datë 24.12.2021 Për miratimin e Koditë të Cilësisë së Arsimit të Lartë</i>  <i>Evidencë 76_Udhëzimi nr 27, datë 29.12.2017</i>  <i>Evidencë 30_Rregullore e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</i>  <i>Evidencë 18_Korrespondencë midis Përgjegjësit të Departamentit dhe koordinatorit të MSC ISDR</i></p>				
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia kryesore - Fakulteti i Biznesit dhe njësia bazë – Departamenti i Financë Kontabilitetit që janë përgjegjës për ofrimin e programit të studimit përmbushin standardet ligjore në fuqi lidhur me organizimin dhe strukturën e këtyre njësive.</li> <li>- Personeli ndihmës akademik dhe administrativ në shërbim të programit të studimit të angazhuar në ndjekjen e praktikave dhe orëve laboratorike është i anagzhuar në nivel departamenti dhe njësie kryesore.</li> <li>- Njësia bazë organizohet në grupe mësimore, kërkimore e shkencore, dhe ka përcaktuar koordinorët e programit të studimit.</li> </ul>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X
Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				
	X				

**Standardi II.3**

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Për këtë program studimi është njësia bazë përgjegjëse, Departamenti Financë Kontabilitet që disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e programit, për strukturën dhe përbajtjen e tij. I gjithë informacioni rreth këtij programi qarkullon, ruhet, arshivohet në bazë të rregullores për Qarkullimin dhe Arkivimin e Dokumentacionit të brendshëm në UAMD. Edhe në faqen zyrtare të UAMD mund të gjendet çdo informacion i vlefshëm për mirë funksionimin e këtij program studimi. Njësia kryesore dhe bazë disponojnë rregulloret përkatëse, rregulloren e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset dhe informacione të tjera të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 47_ Rregullores për Qarkullimin dhe Arkivimin e Dokumentacionit të brendshëm në UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe, në dy vite akademike të ndarë secili në dy semestra me kohëzgjatje normale 15 javë. Lëndët janë të ndara sipas kategorive referuar përcaktimeve ligjore. Kurrikula e programit të studimit përmban 16 lëndë nga të cilat 12 lëndë të detyrueshme dhe 4 lëndë me zgjedhje. Në vitin e parë zhvillohen 11 lëndë, ndërsa vitin e dytë – semestrin e parë pëse lëndë. Praktika mësimore zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë në fund të të cilit mbrohet diploma.</p> <p>Programi vlerësohet gjithsej me 120 kredite:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 9 lëndë/module vlerësohen me 7 kredite;</li> <li>• 4 lëndë vlerësohen me 5 kredite;</li> <li>• 3 lëndë vlerësohen me 4 kredite;</li> <li>• 2 lëndë vlerësohen me 3 kredite.</li> <li>• Praktika që vlerësohet 12 kredite;</li> <li>• Mikroteza që vlerësohet me 13 kredite.</li> </ul> <p>Për sa i përket orëve në auditor, program i studimit parashikon 1.164 orë në auditor, nga të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 720 orë në auditor gjatë vitit të parë;</li> <li>• 444 orë në auditor gjatë vitit të dytë.</li> </ul> <p>GVJ konstaton se ngarkesa në auditor është e balancuar dhe pothuajse uniforme midis semestrave. Plani mësimor parashikon edhe 1.836 orë jashtë auditorit në formën e detyrave/projekteve dhe punës individuale. Pra program i studimit parashikon në total 3.000 orë mësimore gjithsej.</p> <p><i>Tabelat Master Shkencor ISDRpdf.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që synojnë këtë program studimi. Këto informacione kryesisht lidhen me kriteret e përgjithshme e specifike të pranimit, kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Institucioni bën njohjen e lëndëve sipas nenit 39, pika 4 dhe nenit 47 të rregullores së Fakultetit të</p>

	<p>Biznesit dhe sipas vendimeve të shpallura nga Fakulteti i Biznesit mbi transferimet.</p> <p><i>Evidenceë 58_Kriteret e transferimeve për departamentin Financë Kontabilitet</i>  <i>Evidenceë 63_Komision ad hoc për transferimet (Kriteret e transferimit) Vendim nr 14, datë 04.09.2020</i>  <i>Evidenceë 68 Suplementi i ri MSC ISDR</i>  <i>Evidenceë 14 Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidenceë 34_Shkresë për listën fituese të studentëve për transferim studimesh</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Dokumentohet se programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për syllabuset e lëndëve, ku përfshihet edhe ngarkesa mësimore në leksione e seminare. Disponon edhe informacion për praktikat mësimore, si edhe për gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara sipas nenit 53 të rregullores së Fakultetit të Biznesit.</p> <p>Ne përgjithësi syllabueset janë të unifikuara për sa i përket objektivave, temave të lëndës së bashku me çështjet për secilën temë, vlerësimin e studentit dhe literaturën bazë dhe të detyrueshme. Meqënëse evidenca nr. 108 nuk përmbante të gjithë syllabuset e programit, GVJ kërkoi që ti viheshin në dispozicion plani mësimor dhe të gjitha syllabuset e programit të studimit për dy vitet e fundit akademike: për vitin 2021-2022 dhe 2022-2023.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se ka mospërputhje dhe paqartësi në raportim midis planeve mësimore të paraqitura në tabelat nr. 4 dhe nr. 10, si edhe syllabuseve të lëndëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sipas planit mësimor të vitit 2021-2022 është zhvilluar lënda "Kontabilitet i Institucioneve financiare" e cila është e kategorisë "B", ndërsa në planin mësimor të vitit 2022-2023 është zhvilluar në të njëjtin semestër (Viti I, Sem. I) lënda "Sistem tatimor dhe doganor", e kategorisë C me zgjedhje, ndërkohë lënda "Kontabilitet i institucioneve financiare" pavarësisht se është lëndë e detyrueshme nuk raportohet të jetë zhvilluar.</li> <li>• Lënda "Financa ndërkombëtare" e cila përfshihet në planet mësimore të tabelës nr. 4, nuk është përfshirë në planet mësimore të tabelës nr. 10. Për të dy vitet akademike (në tabelën nr. 4), lënda "Financa Ndërkombëtare" prezantohet si lëndë me zgjedhje, ndërsa në syllabusin e saj i përket kategorizimit "lëndë e detyrueshme". Duke e konsideruar lëndën "Financa ndërkombëtare" si të detyrueshme, dhe meqënëse plani mësimor përmban 4 lëndë me zgjedhje (tabela 10), në vitin akademik 2021-2022 rezulton të jenë zhvilluar tre lëndë me zgjedhje (tabela 4). Nga ana tjetër në tabelën nr. 9 "Financa Ndërkombëtare është me zgjedhje" dhe nëse është e tillë në vitin 2022-2023 rezulton të</li> </ul>
	<p>është me zgjedhje" dhe nëse është e tillë në vitin 2022-2023 rezulton të</p>

	<p>jenë zhvilluar pesë lëndë me zgjedhje dhe jo 4 sikurse përcaktohet në planin mësimor të tabelës nr. 10.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidencë 60_VKM 41, datë 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e AL</i>  <i>Evidencë 77_Udhëzim nr 31, datë 29.12.2017</i>  <i>Evidencë 49.1_Riorganizim master nen 20%, 2022-2023</i>  <i>Tabelat Master Shkencor ISDRpdf.</i>  <i>Evidencë shtesë: Tabela ASCAL_MSc ISDR_Aneks.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion dhe dokumentacionit mbështetës, ky program studimi është hapur në vitin akademik 2012-2013, me një periudhë ndërprerje në vitin akademik 2018-2019 dhe më pas nga viti 2019-2020, ka vijuar rregullisht të jetë i hapur. Me riorganizimin e vitit 2018-2019, syllabuset e programit të studimit janë pasuruar me disa elementë sipas kërkesave të VKM 41, datë 24.01.2018, si fjalët kyçe, objektivat, synimet kryesore të lëndës dhe përfitimet nga lënda.</p> <p>Ky program studimi është riorganizuar dy herë gjatë viteve të fundit akademikë. Me vendim të Senatit Akademik nr. 52, datë 01.0.2020 është riorganizuar nën 20% për vitin akademik 2021-2022, për të cilin propozimi i njësisë kryesore nuk është përfshirë në dokumentacionin shoqëruar të RVB, dhe me vendim të Senatit Akademik nr. 34, datë 28.03.2022 për vitin akademik 2022-2023 me propozim të njësisë bazë për zëvendësimin e lëndës “Ekonomiks Menaxherial” me lëndën “Ekonometri” me të njëjta kredite, dhe zëvendësimin e lëndës “Standartet kombëtare të kontabilitetit në institucionet financiare (bankë, sigurime)” me lëndën “Standartet kombëtare të kontabilitetit në institucionet financiare”</p> <p>Nga verifikimi i syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve të studentëve kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyra, projekte, ese – 10% të vlerësimit total;</li> <li>• Provim i ndërmjetëm – 40% të vlerësimit total;</li> <li>• Provimit përfundimtar - 50% të vlerësimit total.</li> </ul> <p>Literatura bazë dhe plotësuese janë pjesë e syllabusit të lëndës. Syllabuset e lëndëve përgatiten nga personeli akademik në shqip dhe anglisht, në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit. Dosja e programit të studimit arkivohet sipas rregullave në fuqi.</p> <p><i>Evidencë 20_Urdhër nr 282, datë 04.07.2013, Urdhër për hapjen e programit të studimit MSC ISDR</i>  <i>Evidencë 19_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite Model</i>  <i>Evidencë 49.1_Riorganizim master nen 20%, 2022-2023</i>  <i>Evidencë 52_Model syllabus në anglisht MSC ISDR</i>  <i>Evidencë shtesë: Msc ISDR_Plani Mesimor_2021-2022.pdf</i></p>



	Evidencë shtesë: Msc ISDR_Plani Mesimor_2022-2023.pdf		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, i cili përmban elementet përkatëse të kërkuara në kuadrin ligjor.</li> <li>- Kuadri rregullator i UAMD parashikon kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera dhe ekuivalentimit të studimeve.</li> <li>- Ka një mospërputhje dhe paqartësi në raportimin e zhvillimit të planit mesimor, p.sh. është zhvilluar një lëndë e cila sipas riorganizimit është zëvendësuar me një lëndë tjetër, numri i lëndëve të detyrueshme dhe lëndëve me zgjedhje të zhvilluara nuk përputhet me planin mesimor të miratuar, etj.</li> <li>- Programi i studimit rezulton të jetë riorganizuar tre here gjatë pesë viteve të fundit akademikë: pas riorganizimit të vitit 2018-2019 sipas dokumentacionit rezulton të jetë riorganizuar dy here nën 20% për dy vite akademikë të njëpasnjëshëm: 2021-2022 dhe 2022-2023.</li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

<b>Standardi II.4</b>	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Për këtë program studimi, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e ngarkesës mesimore sipas lëndëve dhe praktika mesimore si pjesë e programit, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive të studentëve për studime të mëtejshme apo punësim të tyre.</p> <p>Në bazë të planit mesimor, lëndët bazë të detyrueshme janë lëndët që i ofrojnë studentëve njohuri e përgatitje të përgjithshme, si për shembull Ekonometri, Drejtim i avancuar i projekteve dhe Marketing në sigurime. Lëndët karakterizuese lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe pajisin me formim specifik sipas karakteristikave të tij, si për shembull Sigurim i pasurisë dhe i jetës dhe Sigurim detar, Menaxhim risku dhe Amvisim portofoli, Drejtim financiar i avancuar, Tregjet dhe intitucionet financiare, Analiza financiare, Shoqëritë e sigurimeve dhe Kontabiliteti i institucioneve financiare. Lëndët ndërdisiplinore dhe /ose integruese janë</p>

	<p>të mbështetura tek lëndë të fushës kryesore të studimit, financë dhe sigurime si Auditim i shoqërive të sigurimit, rreziku operacional, Sistem tatimor doganor, Kontabilitet financiar i ndërmjetëm etj. Si lëndë plotësuese në program është përfshirë praktika profesionale, të cilën studentët mund të zhvillojnë pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim. Pësha specifike që zë secila kategori e vepritarive formuese brenda këtij program studimi është e përcaktuar pothuaj në përputhje me aktet ligjore e nën ligjore në fuqi.</p> <p>GVJ sugjeron që mund të bëhet një kategorizim tjetër i lëndëve sipas veprimtarisë: lëndë si “Drejtimit i avancuar i projekteve” dhe “Marketing në sigurime” nuk janë lëndë të përgatitjes së përgjithshme, por janë lëndë integruese me disiplina të tjera të fushës së ekonomisë. Ndërkohë lëndë si “Menaxhim risku dhe anvisim portofoli”, “Tregjet dhe institucionet financiare” apo “Shoqëri sigurimi” janë lëndë që ofrojnë një kulturë të përgjithshme që lidhet me objektivin e programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu në planin mësimor ka paqartësi dhe mospërputhje lidhur me lëndët nëse janë me zgjedhje apo të detyrueshme, dhe në cilin semestër zhvillohen.</p> <p><i>Evidenca 79_VKM 879, datë 18.12.2019 Disa ndryshime e shtesa në VKM 41, datë 24.01.2018</i></p> <p><i>Evidencë 49_Riorganizimi Master FB 2021-2022, vendim senati</i></p> <p><i>Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR 2018-2019</i></p>
<p><b>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe kërkimit shkencor.</b></p>	<p>Konstatohet nga dokumentacioni se lëndët/modulet shpërndarja në vite akademike e semestra, vlerësimi i lëndëve në kredite e orë mësimore, orë në auditor e punë individuale e studentëve, mundësojnë realizimin e objektivave formues të programit të studimit dhe të rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimit profesional.</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe programeve lëndore, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestra sipas lëndëve dhe moduleve është përgjithësisht e balancuar dhe mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimit profesional në fushën e shërbimeve bankare dhe financiar.</p> <p>Vlerësimi në kredite i lëndëve në secilën kategori është në përputhje me fokusin e çdo lënde, si dhe pësha e lëndëve për secilën kategori është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në planin mësimor lëndët janë të shpërndara në vite akademike, në semestra, në fillim paraqiten lëndët bazë, pastaj lëndët formuese, duke respektuar nivelin e 25 orëve në javë bazuar në kurrikulën e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 49.1_Riorganizim master nen 20%, 2022-2023</i></p> <p><i>Evidencë 60_VKM 41, datë 21.01.2018</i></p>

	<p><i>Evidencë 79_VKM 879, datë 18.12.2019 Disa ndryshime e shitesa në VKM 41, datë 24.01.2018</i></p> <p><i>Evidencë 50_Udhëzimi nr 31, datë 29.12.2017</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Për këtë program studimi ndarja e elementeve të programit sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritje e realizim të objektivëve formues, transferim të studimeve, mobilitete dhe punësim në përfundim të studimeve, mbështetur në dosjen e riorganizimit të programit të studimit, e cila është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bazuar në kurikulën e programit të studimit, ky program ndërthur formimin teorik të studentëve me formimin praktik.</p> <p>Referuar planit mësimor, ndarja e orëve në auditor në leksione dhe seminare është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksione – 814 orë mësimore</li> <li>• Seminare – 350 orë mësimore</li> </ul> <p>Raporti Teori (leksione) / Praktikë (ushtrime/seminare) rezulton 814 orë teori / 350 orë praktikë ose afërsisht 70% / 30%. Në fakt raporti i njohurive praktike është edhe më i lartë duke patur parasysh që 90 orë praktikë mësimore në planin mësimor janë përfshirë në orët e leksioneve.</p> <p>Studentëve të këtij program u ofrohen mundësi të kryejnë mobilitete në kuadrin e programeve Erasmus + por jo vetëm, duke qenë se veprimtaria formuese e këtij program është e ngjashme me programe të tjera të ngjashme në universitete të huaja. Praktika mësimore si detyrim përmbyllës u jep mundësi studentëve të punësohen.</p> <p><i>Evidencë 49.1_Riorganizim master nen 20%, 2022-2023</i>  <i>Evidencë 21_Kurrikula të ngjashme me IAL të tjera</i>  <i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSC ISDR</i>  <i>Evidencë 74_Pyetësor vlerësimi I studentëve pas përfundimit të studimeve në Bsc Msc</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke</p>	<p>Programet e lëndëve/modulet e programit të studimit, përditësohen vazhdimisht në departament. Miratohen nga Departamenti Financë Kontabilitet në fillim të vitit akademik. Programet e lëndëve janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë ngarkesën semestrale të lëndës për 15 javë, të ndarë në orë leksioni, seminari, laboratorë, saktësojnë objektivat e</p>

<p>përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>lëndës, përfitimet nga lënda, me qëllim që studentët të marrin aftësitë duhura profesionale, kompetencat e duhura, sipas kërkesave të tregut. Këto programe lëndësh përfshijnë edhe literaturën bazë, të detyrueshme edhe atë plotësuese.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve GVJ konstaton se në disa raste literatura bazë nuk përputhet plotësisht me emërtimin e lëndës, vecanërisht për lëndët që kanë në fokus sigurimet. Rekomandohet i njëjti libër në disa lëndë dhe jo gjithmonë tekstet e rekomanduara janë të viteve të fundit. Gjatë takimit me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi se pedagogët angazhohen që nëpërmjet rasteve studimorë, dhe punimeve/artikujve shkencorë t'u ofrojnë studentëve njohuri sa më aktuale dhe praktike në lëndët përkatëse.</p> <p>Departamenti Financë Kontabilitetit bën kërkesë për literaturën e nevojshme, sipas kërkesave të pedagogëve, për sigurimin e librave në mënyrë që syllabuset e lëndëve të përditësohen me literaturë të 5 viteve të fundit. Pas shqyrtimit të buxhetit dhe projekt/buxhetit të institucionit, GVJ konsaton se lidhur me përditësimin e titujve nuk janë kryer shpenzime për blerje librash, por vetëm shpenzime për abonime në biblioteka online.</p> <p><i>Evidencë 178_Vendim në mbledhje departamenti 06.10.2022</i>  <i>Evidencë 177_Email blerje librash</i>  <i>Evidencë 68_Suplement i ri MSc ISDR</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Dokumentohet nga institucioni, se rezultatet e pritshme të të nxëniet pas dy viteve të studimit, janë rritja e aftësive, e kompetencave, e mundësive për të gjetur punë në përputhje me shkollimin, mundësi për të vijuar më tej studimet. Një dokument i rëndësishëm që pasqyron këto përfitime është edhe suplementi i diplomës, i cili i jepet studentëve nga Fakulteti në përfundim të studimeve e diplomimit në dy gjuhë shqip e anglisht. Po kështu, një pasqyrim i mirë i rezultateve të pritshme bëhet edhe në analizën e ecurisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 68_Suplementi i ri MSC ISDR</i>  <i>Evidencë 49.1_Riorganizim master nen 20%, 2022-2023</i>  <i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSC ISDR</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit ka përmbajtjen e duhur dhe i krijon studentëve mundësi për vijimësinë e mëtejshme të studimeve, natyrisht në plotësim të kriterëve. Tregu i sigurimeve është i ri e me perspektivë, kjo është sërish mundësi e mirë për punësimin e studentëve që përfundojnë studimet në këtë master.</p> <p><i>Evidencë 71_Përshkrim program studimi</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, shpërndarja mes veprimtarive formuese, raporti teori-praktikë dhe</li> </ul>

	<p>ngarkesa në kredite janë në përputhje me profilin e programit të studimeve në fushën sigurimeve dhe menaxhimit të rrezikut.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuar sipas kërkesave të tregut të punës dhe mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve të thelluara në cikle studimi më të larta.</li> <li>- Ka mospërputhje midis planeve mësimorë për sa i përket lëndëve me zgjedhje dhe semestrave/viteve të zhvillimit të lëndëve.</li> <li>- Kategorizimi i lëndëve sipas veprimtarive nuk është bërë sipas natyrës dhe obektivave të lëndëve.</li> </ul>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi ILS	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i studimit, ka për synim plotësimin e kërkesave të tregut për studentë të përgatitur për sektorin e sigurimeve e të drejtimit të rrezikut. Studimi i tregut, panaiet që zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, i shërbejnë këtij synimi. Institucioni ka lidhur marrëveshje si me institucione, me biznese, me qëllim që studentët të kenë mundësi të marrin informacion për këto mundësi edhe përmes aktiviteteve të përbashkëta që zhvillon institucioni UAMD.</p> <p><i>Evidencë 74_Pyetësor vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve BsC MsC MP</i></p> <p><i>Evidencë 45_Analiza e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamentin Financë Kontabilitet, 2022-2023</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Dokumentohet në rregulloren e Fakultetit të Biznesit, neni 22, pika 1 se UAMD nxit e garanton përfshirjen e studentëve në vendimarrje. Studentët vlerësojnë procesin akademik përmes plotësimit të pyetësorëve drejtuar studentëve. I gjithë ky proces i realizuar nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standartevetë Cilësisë dhe Studentëve, ndihmon institucionin të përmirësojë cilësinë.</p> <p>Në zbatim të legjislacionit në fuqi UAMD, Fakulteti i Biznesit, në kuadrin e programit të studimit studimit ka ngritur dhe ka funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, duke zbatuar strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, pra duke përfshirë studentët dhe bashkëpunëtorë ekspertë të jashtëm (për GVB), sipas nenit 2 të rregullores së NJSBC.</p>

	<p>UAMD mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, konsultohet me ta rreth problematikave të programit të studimit, përmirësimit të kurrikulave, për të ndihmuar Departamentin Financë Kontabilitet në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, të lidhjes së formimit teorik me atë praktik, duke u referuar edhe eksperiencave të fituara tashmë në punë prej tyre. Informacioni e lidhja me studentët e diplomuar merret përmes pyetësorëve, por edhe takimeve, konferencave, mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me Alumni të këtij fakulteti e program studimi.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidencë 132_Pyetësor i studentëve</i>  <i>Evidencë 70_Ngritja e grupeve të GVB për proces akreditimi</i>  <i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i>  <i>Evidencë 74_Pyetësor vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve BsC MsC MP</i>  <i>Evidencë 175 Analiza e ecurisë së programit të studimit MSC ISDR</i></p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti Financë Kontabilitetit në bashkëpunim me institucione publike e private, në zbatim të marrëveshjeve me to, përmirëson, përditëson programin e studimit në përputhje me kërkesat e nevojat e tregut, në përputhje me kërkesat e institucioneve publike, private, bizneset, duke i përfshirë përfaqësues të tyre në mësimdhënie, në leksione të hapura sipas fushës së studimit të këtij programi studimi. Disa nga institucionet me të cilat ky program studimi ka marrëveshje janë, shoqëritë e sigurimit, fondet e pensioneve private etj.</p> <p><i>Evidencë 35_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit me bizneset</i>  <i>Evidencë 73_Pyetësor shpërndarë ekspertëve për përmirësimin e kurrikulave</i></p>				
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UAMD është i angazhuar në një program të vazhdueshëm të përmirësimit të kurrikulave të të gjitha programeve që ai ofron duke reflektuar opinione të paleve të përfshira, si studentët dhe përfaqësues të sektorit financiar.</li> <li>- Institucioni angazhohet që të përmirësojë programin e studimit nëpërmjet bashkëpunimit me aktorë të tregut, në mënyrë që të garantohet një proces serioz dhe cilësor i hartimit/rishikimit të kurrikulave të programit të studimit.</li> </ul>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="background-color: #cccccc;">Përmubshet kryesisht</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmubshet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="width: 50%;"></td> <td style="width: 50%;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmubshet kryesisht	Përmubshet plotësisht		<b>X</b>
Përmubshet kryesisht	Përmubshet plotësisht				
	<b>X</b>				

*Lee*  
*Com*

**Standardi II.6****Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit, ka pasqyruar qartë në të prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe të kërkimit shkencor. Programi i studimit ka në bazë edhe Planin Strategjik të Fakultetit të Biznesit dhe Planin Strategjik të Departamentit të Financë Kontabilitetit. Sipas planit strategjik të institucionit, kërkimi shkencor mbetet një nga prioritetet strategjike kryesore, fokusuar në nxitjen dhe promovimin e ekselencës akademike. Kjo reflektohet në shumëllojshmërinë e fushave të studimit specifike dhe ndërdisiplinore, në rritjen e produktit shkencor të stafit akademik si edhe nëpërmjet promovimit e diskutimit të rezultateve kërkimore nëpërmjet organizimit të konferencave, ëorkshop-eve, tryezave të rumbullakëta, simpoziumeve, etj.</p> <p><i>Evidencë 71 Përshkrimi Program Studimi Msc ISDR</i>  <i>Evidencë 26 Fushat kërkimore shkencore për departamentin Financë Kontabilitet</i>  <i>Evidencë 11 Plani strategjik Fakulteti Biznesit 2021-2025</i>  <i>Evidencë 12 Plani strategjik Departamenti Financë Kontabilitet 2021-2025</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit e Departamenti i Financë Kontabilitetit përgjigjen për koordinojnë e drejtojnë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore e shkencore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Kjo veprimtari rregullohet me anë të marrëveshjes së personelit akademik e drejtuesit të njesisë kryesore dhe njesisë bazë. Në çdo fillim të vitit akademik, në department ndahet ngarkesa mësimore sipas semestrave, sipas planit mësimor dhe orarit zyrtar të shpallur edhe në faqen e zyrtare te institucionit. Përveç leksioneve-e seminareve, zhvillohen edhe leksione të hapura nga personalitete të fushës së biznesit, të institucioneve qendrore apo lokale për të paraqitur eksperiencat e tyre me pedagogët e studentët. Edhe konferencat shkencore të Fakultetit të Biznesit, por jo vetëm janë mundësi e mirë për koordinimin e veprimtarisë akademike e asaj kërkimore. Liria akademike e peronelit sanksionohet në nenin 5 të statutit të UAMD.</p> <p><i>Evidencë 2 Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i>  <i>Evidencë 29 Marrëveshjet për organizimin e kohës vjetore të punës për stafin akademik të Departamentit Financë Kontabilitet</i>  <i>Evidencë 69 Ngarkesa Mësimore e Departamentit Financë Kontabilitet</i>  <i>Evidencë 187 Orari mësimor Master ndër vite</i>  <i>Evidencë 31 Emaile shkëmbimi për aktivitete shkencore stafi akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon</p>	<p>Programi i studimit është ndërtuar në mënyrë të tillë që të nxisë e përgatisë studentët të përfshihen në studime e projekte, apo në aktivitete kërkimore</p>

studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	së bashku me pedagogët e tyre. Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se në konferencat shkencore të organizuara nga Fakulteti i Biznesit, ftohen të bëhen pjesë e punimeve edhe studentët, qoftë për të përgatitur e prezantuar apo edhe për të marrë pjesë.  <i>Evidencë 198_Njoftim punësimi për studentë</i>						
<b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Nga vizita në institucion dhe dokumentat konstatohet se UAMD për të nxitur punën kërkimore dhe për të ngritur nivelin akademik e kërkimor të personelit akademik të programit të studimi, financon pjesmarrjet në konferenca, apo botimet e artikujve në revista me Scopus, duke rimbursuar tarifën e paguar nga personeli akademik. Kjo është një formë e mirë dhe një mekanizëm i përshtatshëm për të inkurajuar veprimtarinë kërkimore. Duke shqyrtuar buxhetin e viteve të fundit, GVJ konstaton se vlera e shpenzimeve që i përket kërkimit shkencor është e vogël – rreth 1,3% për vitin 2022.  <i>Evidencë 54_Rregullore për manaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore</i> <i>Evidencë 61_Financimi i botimeve të indeksuara me Scopus</i> <i>Evidencë 62.1_Thirrje për aplikim për projekte kërkimore shkencore 2022</i>						
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i>  <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi i studimit përcakton qartë në rregullore prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</li> <li>- Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon stafim akademik dhe studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, për financimin e të cilave njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni, por nevojitet një angazhim dhe përfshirje reale e studentëve.</li> </ul>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			<b>X</b>
Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		<b>X</b>					

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të	Departamenti Financë Kontabilitet, përgjegjës për programin e studimit, mbështet grupet e lëndëve dhe projektet e reja kërkimore shkencore dhe siguron bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Nga takimi në institucion u përmend si shembull e praktikë e mirë projekti në fushën e



programit të studimit në kërkim shkencor.	sigurimeve i miratuar në department. Ai përputhet edhe me fushën e studimit të doktoraturës, dhe i shton vlerë programit të studimit. <i>Evidencë 62_Formular projekt propozimi-Prof.Dr.Luljeta Kikino</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti Financë Kontabilitetit zhvillon analiza të punës kërkimore shkencore çdo vit dhe e raporton; zhvillon studime e projekte me karakter kërkimor shkencor; miraton fushat e studimit të doktoraturës, të cilat i miraton njësia kryesore. Për hartimin e projekteve angazhohet i gjithë personeli akademik. Për arritjen e objektivave të kërkimit angazhohen e nxiten edhe studentët e programit të studimit. Edhe përmes përgatitjes së punimit diplomës apo mikrotezës, bashkëpunimi pedagog student është i rëndësishëm për realizimin e objektivave të kërkimit shkencor. <i>Evidencë 67_Model teme diplome, studentë MSC ISDR</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Fakulteti i Biznesit realizon Konferencën e Fakultetit, në të cilën marrin pjesë personeli akademik me kohë të plotë të pjesëshme, studentë alumni, studentët e programit të studimit. Ata angazhohen në përgatitje e prezantim punimesh apo edhe si pjesmarrës dëgjues. Konferencat shkencore ndihmojnë si personelin akademik edhe studentët për të arritur objektivat e punës kërkimore e shkencore. <i>Evidencë 201_Vendim për grupet e punës në konferencën e Fakultetit Biznesit 2021-2022</i> <i>Evidencë 202_Vendim Dekanati Konferenca Studentore 2020</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	UAMD, përmes programit të studimit ka si objektiv formimin e profesionistëve konkurrues për tregun e sigurimeve, por jo vetëm, sipas dokumentit "Analiza e ecurisë së Master Shkencave ISDR". Përmes mobiliteteve Erasmus +, në kuadrin e ndërkombëtarizimit ky program u ofron studentëve mundësi studimi, praktikash mësimore dhe mundësi punësimi në institucione me degë apo njësi në shtete të ndryshme. <i>Evidencë 176_LA Arlinda Negruti</i> <i>Evidencë 35_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit me bizneset</i> <i>Evidencë 94_Komunikim email_Njoftim mbi internship</i> <i>Evidencë 49.1_Riorganizim master nën 20%, 2022-2023</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Departamenti Financë Kontabilitetit, përmes programit të studimit, ofron kurrikul të pasur e të përshtatëshme për studentët që duan të bëhen pjesë e profesionit në fushën e sigurimeve dhe të drejtimit të riskut në institucione të kësaj fushe, duke u krijuar mundësi dhe orientuar drejt marrjes së certifikatave të ndryshme të këtij sektori për të gjetur vendin e tyre në tregun e sigurimeve.
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.

dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).									
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia përgjegjëse mbështet grupet e lëndëve dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore si dhe ofron pëdorimin e infrastrukturës për realizimin e objektivave të projekteve.</li> <li>- Institucioni organizon konferenca shkencore dhe workshope ku marrin pjesë me referime stafi akademik dhe kërkimor. Institucioni nxit përfshirjen e studentëve në konferenca shkencore.</li> <li>- Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</li> </ul>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyhet plotësisht</th> <th>Përmbyhet kryesisht</th> <th>Përmbyhet pjesërisht</th> <th>Përmbyhet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet				X
Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>			X	
--	--	--	---	--

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në çelës studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Bazuar në dokumente si: rregullore e programit të studimit, rregullore e Fakultetit të Biznesit, rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet, dhe në planin mësimor ngarkesa ndahet në leksione, seminare, laboratorë.. Format e mësimdhënies në UAMD paraqesin veçori, pasi orët e mësimimit janë ta pandara në leksione e seminare, në shumë raste i njëjti pedagog zhvillon leksionet dhe seminarat. Në programin e lëndës specifikohen edhe detyrimet e studentit për të shlyer lëndën si test i ndërmjetëm, provim përfundimtar, detyrë apo projekt kursi, të gjitha në shërbim të transmetimit të dijeve e njohurive tek studentët.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p>

	<p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet</i>  <i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>UAMD, përmes programit të studimit, ofron kurrikul në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të përshtatur me kushtet e tregut. Procesi i mësimdhënies kryhet nga ana e personelit akademik duke përdorur metoda alternative mësimdhënie e mësimnxënie, duke iu përgjigjur nevojave e interesit të studentëve. Gjatë zhvillimit të lëndëve sipas planit mësimor, realizohen edhe leksione të hapura nga ekspertë të fushës së sigurimeve e të manaxhimit të rrezikut, mësim në laboratore, seanca ushtrimesh e diskutimesh, si dhe prezantim i projekteve të kursit në grup. Gjatë periudhës së pandemisë, mësimi u zhvillua online përmes platformave Teams, Classroom, Moodle. UAMD mundësoi edhe trainime për përdorimin e këtyre platformave për personelin akademik, duke përgatitur edhe manual përdorimi për studentët. Departamenti Financë Kontabilitet monitoroi zhvillimin e mësimit online, përmes raportimeve nga vetë platforma dhe evidentimi i tyre me formularë përkatës për çdo lëndë e çdo lektor.</p> <p><i>Evidencë 39_Përmbledhëse e metodave interactive të përdorura për mësimdhënie</i>  <i>Evidencë 90.1_Trainim për mësim online Moodle</i>  <i>Evidencë 90_Raport monitorimi të mësimit online Rezultate Teams</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UAMD përmirëson në vijimësi aftësitë e personelit akademik për mësimdhënie, apo aftësitë didaktike përmes marrjes së eksperiencave si brenda vendit edhe jashtë vendit, këto të fundit përmes shkëmbimeve të trainimit me universitete të huaja në zbatim të programeve Erasmus+, financuar nga KE. Bashkëpunimet janë të mbështetura në marrëveshje të lidhura mes UAMD e institucioneve financiare apo me bizneset.</p> <p><i>Evidencë 33_Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel institucional</i>  <i>Evidencë 37_Trainime e mobilitete Erasmus +, PAE viti 2017-2022</i>  <i>Evidencë 178_Vendime në mbledhje departamenti 06.10.2022</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në UAMD personeli akademik i angazhuar në programin e studimit mban grada e tituj shkencorë të fituar brenda e jashtë vendit, është me eksperiencë disa vjeçare e me përvojë në mësimdhënie si në universitete shtetërore dhe në ato private. Gjatë zhvillimit të orëve të leksionit e të seminareve, lektorët zhvillojnë mësimin në mënyrë interaktive, pra duke përfshirë edhe studentët në diskutim përmes pyetjeve që drejton lektori apo pedagogu në sallë dhe diskutimit në detaje të çështjes duke përfshirë edhe studentët në diskutim. Përveç kësaj përfshirja e studentëve bëhet edhe përmes konferencave studentore, konkurseve të ndryshme të organizuara nga AMF përmes Lojës së Bursës, apo nga AADF (ku përzgjidhen punimet më të mira), apo përmes pjesmarrjes në projekte të ndryshme në institucione të tjera.</p>

	<p><i>Evidencë 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit Financë Kontabilitet.</i></p> <p><i>Evidencë 96_Departamenti Financë Kontabilitet Tituj e Grada në vitet 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 105_Konferenca studentore e organizuar nga Fakulteti Biznesit</i></p> <p><i>Evidencë 106_Njoftime për aktivitete, Metodologjia</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Dokumentohet se Departamenti Financë Kontabilitet përgjegjës për programin e studimit zhvillon analiza vjetore si për mësimin edhe për punën kërkimore, pasi merret opinion i të gjithë personelit akademik sipas lëndëve / disiplinave. Në këtë analizë vjetore departamenti vlerëson përputhshmërinë e metodave të mësimdhënies me objektivat formues, të përcaktuar në dokumenta si: rregullore e Fakultetit të Biznesit, rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet, rregullore e programit të studimit. Studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të metodave të mësimdhënies, përmes përgjigjeve të dhëna prej tyre në pyetësorët e shpërndarë nga NJSBC. Sugjerimet e tyre për më shumë praktikë mësimore apo lidhje të teorisë me praktikën Fakulteti e Departamenti i janë përgjigjur duke shtuar mundësitë për bashkëpunime me bizneset apo për zhvillimin e disa lëndëve apo temave në laboratorë.</p> <p><i>Evidencë 32_Analiza vjetore e departamentit Financë Kontabilitet</i></p> <p><i>Evidencë 74_Pyetësor vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve BsC MsC MP</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore e programit të studimit MSC ISDR</i></p> <p><i>Evidencë 55_Aktivitete Fakulteti I Biznesit</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Nga dokumentat dhe vizita në UAMD rezulton se janë ngritur të gjitha strukturat për garantimin e cilësisë së mësimdhënies. Kështu, është ngritur me vendim të titullarit të institucionit NJSBC në rang universiteti, është miratuar edhe rregullorja e kësaj njësie, me qëllim mbështetjen, motivimin, nxitjen e mësimdhënies me metoda inovative, për të tërhequr vëmendjen e studentëve, për ta bërë mësimin më interaktiv. UAMD ka të saktësuar në politikat e veta edhe trainimin e personelit akademik, si dhe sigurimin e kushteve për pjesmarrje në mobilitete në universitete të huaja në kuadër të programeve Erasmus+.</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidencë 39_Përmbledhëse e Metodave interaktive të përdorura për mësimdhënie</i></p> <p><i>Evidencë 174_Njoftime nga Institucioni për pjesmarrje në Erasmus</i></p> <p><i>Evidencë 37_Trainime dhe mobilitete Erasmus+, PAE vitet 2017-2022</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi i studimit përmban forma të shumëllojshme të mësimdhënies dhe mësimxënies mbështetur në aktet rregullatore të institucionit dhe në funksion të arritjes së synimeve të programit.</li> <li>- Procesi mësimor është i fokusuar tek studenti për të lehtësuar mësimxënien dhe karakterizohet nga praktikat më të mira.</li> <li>- UAMD mbështet kualifikimin në drejtim të përmirësimit të kompetencave didaktike të stafit.</li> </ul>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <td style="width: 25%;"></td> <td style="width: 25%;"></td> <td style="width: 25%;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="width: 25%;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

### Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Konstatohet se UAMD dhe Fakulteti i Biznesit kanë miratuar aktet nënligjore në zbatim të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në RSH”, lidhur me mënyrën e vlerësimit të studentëve të ciklit të dytë. Më konkretisht, në rregulloren e programit të studimit, neni 68, pika 1-6, në rregulloren e Fakultetit të Biznesit, neni 59, dhe në rregulloren e provimeve, neni 2, shihet se studentët informohen për mënyrën e vlerësimit të dijeve të tyre, përmes skemës së vlerësimit me pikë dhe të konvertuara në notë, konkretisht pikët totale ndahen në këtë mënyrë: në pjesmarrje e aktivizim në leksione e seminare, testi i ndërmjetëm, projekti apo detyra e kursit, provimi përfundimtar. Ky informacion i rëndësishëm u jepet studentëve qysh ditën e parë të nisjes së lëndës, apo në leksionin e parë, kur bëhet edhe prezantimi i programit të lëndës.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu</i>  <i>Evidencë_Rregullore e programit të studimit MSC ISDR</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidencë 59_Rregullore e provimeve të Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidencë 108_Syllabuse sem 2_2021-2022</i>  <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	
	<p>Në programin e studimit, vlerësimi i studentëve bëhet përmes 4 elementëve: vlerësimi për aktivizimin, për testin e parë apo të ndërmjetëm, për detyrën apo projektin e kursit dhe vlerësimi për provimin përfundimtar. Totali i pikëve të fituara nga student në të gjithë këta elementë, mundëson vlerësimin e studentit me notë për lëndën përkatëse. Studentët e marrin informacionin për detyrimet e tyre në lëndë përveç se nga rregulloret edhe nga lektori ditën e parë të mësimin në atë lëndë.</p> <p><i>Evidencë 59_Rregullore e provimeve të Fakultetit të Biznesit</i></p>

	<i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet</i> <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në rregulloren e institucionit, njësisë kryesore dhe të programit jepen sistemi i vlerësimit, format e vlerësimit dhe format e kontrollit të dijeve, dhe njihen nga studentët.</li> <li>- Vlerësimi përfundimtar i studentit kryhet nëpërmjet vlerësimit gjatë semestrit, detyrave dhe projekteve të kursit si edhe vlerësimit gjatë testeve të lëndës.</li> <li>- Në fillim të çdo viti akademik studentët informohen për me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve.</li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulet.	Dokumentohet në rregulloren e Fakultetit të Biznesit neni 59 dhe 63, në rregulloren e provimeve, neni 2, në syllabuset e lëndëve mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive nga ana e studentëve të këtij programi studimi. Në syllabus përcaktohet se vlerësimi i lëndës bëhet duke grumbulluar pikët e pjesmarrjes e aktivizimit në mësim, të testit parë të ndërmjetëm, të detyrës kursit dhe të provimit përfundimtar. Studentët kanë mundësi të hyjnë në provim për të marrë notë kaluese apo për përmirësim note tre herë: në sezonin e dimrit, në sezonin e verës dhe në sezonin e vjeshtës. Ndërsa, mundësitë për t'u diplomuar janë dy: në Korrik dhe në Shtator.  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Evidencë 59_Rregullore e provimeve të Fakultetit të Biznesit</i> <i>Evidencë 108_Syllabuse Sem II, viti 2021-2022.</i> <i>Evidencë 193_Vendim për ngrite komisioni ad-hoc për mbrojtje të praktikave mësimore dhe mikrotezave</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për të rritur transparencën dhe saktësinë në vlerësimin e studentëve Fakulteti i Biznesit përdor platformën Clean Score për korrigjimin e provimeve. Përgjigja e provimeve i vjen në kohë reale pedagogut, së bashku me analizë të rezultateve e kalueshmërisë. Kjo është mundësi e mirë për korrigjimin e provimeve që zhvillohen me alternativa, pasi siguron shpejtësi e saktësi në përgjigjet dhe vlerësimin e studentëve. Parashikohet në rregulloren e programit të studimit, neni 14 edhe forma të tjera testimi
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me	

<p>syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>bazuar në llojin e lëndës si dhe munësisë së zhvillimit në laborator apo në auditor.</p> <p>Sipas legjislacionit në fuqi dhe dokumentave të programit të studimit, vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe rregulloret përkatëse ku mbështetet ky program.</p> <p><i>Evidencë 169_Email njoftim Clean Score për digitalizimin e procesit të zhvillimit të provimit.</i></p> <p><i>Evidencë 170_Trainim për Clean Score 2018-2019</i></p> <p><i>Evidencë 171_Takim me përfaqësues të Clean Score Durrës në Departamentin Financë Kontabilitet</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore e programit të studimit MSC ISDR</i></p> <p><i>Evidencë 60_VKM nr 41, datë 24.01.2018</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në dokumenta dhe vizitën në institucion, studentit i krijohet mundësi të ketë vlerësim të plotë përmes disa elementeve, jo vetëm me provim por edhe përmes detyrës apo projektit të kursit. Bazuar në rregulloren e provimeve, neni 3, studentit i jepet mundësia të diskutojë në klasë rezultatet e provimit të parë, me qëllim që të përmirësojë rezultatet në provimin përfundimtar. Detyra e kursit si punë në grup dhe prezantim në klasë si grup i nxit studentët të përmirësojnë vlerësimin e tyre krahasuar me vlerësimin që kanë patur në provim.</p> <p><i>Evidencë 59_Rregullore e provimeve të Fakultetit të Biznesit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e provimeve, neni 3 e 4, dhe në nennin 60 të rregullores së Fakultetit të Biznesit, procesi i provimeve zhvillohet më të paktën dy vetë komision provimi, lektori dhe pedagogu i seminareve, për të shmangur plagjiaturën apo kopjimin. Po kështu, vendosja e një programi antiplagjiaturë në fakultet i mundëson pedagogëve të diktojnë nëse ka patur plagjiaturë në detyrat e kursit apo mikrotezat e dorëzuara për vlerësim.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Evidencë 59_Rregullore e provimeve të Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet</i></p> <p><i>Evidencë 80_Asistime Grafiku provimeve përfundimtare_Master_sem II_2021-2022</i></p> <p><i>Evidencë 173_Raporti i AKKSHI për laboratorin e doktoraturës datë 12.10.2022</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> <p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për</p>	<p>Studentët e programit të studimit, vlerësohen në përputhje me arritjet e tyre në të gjithë elementët përbërës të vlerësimit, të parashikuara në rregulloren e Fakultetit, në rregulloren e programit të studimit, në rregulloren e provimeve si edhe në syllabusin e lëndës. Rezultatet jepen në kohën e duhur, sipar informimit që u është bërë studentëve për shpalljen.</p>

rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në këto rregullore parashikohet e drejta e studentëve për të kërkuar rishikim të provimit, apo ballafaqim me rezultatet e provimeve, nëse nuk janë të bindur për vlerësimin.		
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në raste kur ka ankesa edhe pas ballafaqimit të rezultateve të provimeve nga ana e lektorit me studentët, ngrihet komision tjetër provimi nga ana e përgjegjës të njesisë bazë për të rivlerësuar rezultatin, pas kërkesës së drejtuar nga studenti pranë sekretarisë mësimore, në zbatim të rregullores së Fakultetit të Biznesit. <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Evidencë 59_Rregullore e provimeve të Fakultetit të Biznesit</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet me anë të vlerësimit të vazhdueshëm përgjatë vitit.</li> <li>- Institucioni ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat rrisin transparencën e vlerësimit. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</li> <li>- Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b> Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Në bazë të dokumentave dhe vizitës në UAMD, konstatohet se programi i studimit është i përshtatur me kërkesat e tregut të punës, ndaj edhe i përgatit studentët për specialitete të tregut të sigurimeve e të drejtimit të rrezikut. Kjo bën që kurrikula e këtij programi studimi të synojë përgatitjen e pajisjen e studentëve me njohuri të mira teorike e praktike. <i>Evidencë 71_Përshkrim program studimi Msc ISDR</i> <i>Evidencë 51_Riorganizm I Msc ISDR 2018-2019</i> <i>Evidencë15_Model Suplement Diplome</i> <i>Evidencë 74_Pyetësor vlerësimi studentëve pas përfundimit të studimeve Bsc, Msc, MP</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë	Programi i studimit, i çelur për të plotësuar kërkesat e tregut të sigurimeve me specialistë, garanton zhvillimin e aftësive të studentëve në disa disiplina të ndërlidhura me ato të financës e të sigurimeve, të tilla si teknologjia e



<p>së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>informacionit, shkencat humane, sociale të komunikimit. Kështu nëse i referohemi planit mësimor, gjenden të ndërthurura disiplina sipas kategorizimit A/B/C/D. Syllabuset e lëndëve, të paraqitura në të dy gjuhët shqip e anglisht, saktësojnë metodologjinë e mësimdhënies, mësimi zhvillohet në laborator, apo përmes classroom, për të aftësuar studentët për përvetësimin më të mirë të dijeve.</p> <p><i>Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20% viti 2022-2023</i>  <i>Evidencë 108_Syllabus sem II 2021-2022</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në përfundim të lëndës (në fund të semestrit) pedagogët e lëndës realizojnë përsëritje të lëndës, ushtrimeve, rasteve, për të shqyrtuar kompetencat e studentëve të marra gjatë zhvillimit të lëndës, por dhe për të orientuar studentët për provimin përfundimtar. Departamenti shpall edhe orët e konsultimeve për çdo pedagog, po kështu edhe pushimi disa ditë për çdo provim ndihmon studentët të përsërisin lëndën. Në fund të vitit lektorët së bashku me koordinatoren e programit të studimit orientojnë studentët për detyrimet përmbyllëse, si praktika mësimore dhe mikroteza.</p> <p><i>Evidencë 19_Model syllabusi</i>  <i>Evidencë 88_Orari I konsultimeve</i>  <i>Evidencë 84_Kalendari akademik master 2021-2022 sem I</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në UAMD, në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloret e programit të studimit, studentëve u jepet mundësi në disa lëndë me orientim praktik, të zhvillojnë njohuritë e marra në leksion, në laboratorë apo duke kryer praktikat profesionale, në biznese të fushës së sigurimeve, por jo vetëm. Kështu, bazuar në rregulloren e Praktikës Mësimore, në përfundim të ciklit të studimit, studentët zhvillojnë deri në një semestër praktikë mësimore. Për këtë fakulteti ka lidhur marrëveshje me institucione e subjekte që ndihmojnë studentët të bëjnë praktika profesionale. Personeli akademik i programit të studimit krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, për të krijuar mundësi të mëtejshme studimi e kërkimi shkencor, duke i mbështetur studentët për pjesmarrje me punime të përbashkëta me pedagogët apo për të organizuar konferenca studentore.</p> <p>Pjesmarrjet e mobilitetit përmes programit Erasmus+ janë ndihmesë e madhe për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, të punës kërkimore.</p> <p><i>Evidence 91_Kurrikula dhe plni mësimor Msc ISDR me vulë senati</i>  <i>Evidence 83_Rregullore për praktikat mësimore</i>  <i>Evidence 27_Marrëveshje bashkëpunimi të Fakultetit të Biznesit</i>  <i>Evidence 130_Historiku I konferencës studentore dhe njoftimet që u janë cuar studentëve për pjesmarrje</i>  <i>Evidence 137_Komunikim me emailë për praktika pune</i>  <i>Evidence 62_Njoftime nga institucioni për pjesmarrje në Erasmus+</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë apo me kontratë, përpos orëve të planifikuara të leksioneve e seminareve, informojnë studentët për leksione</p>

orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	të hapura nga profesionistë të fushës, për të rejat e zhvillimit të sektorit të sigurimeve.  <i>Evidence 142_ Leksione të hapura dhe aktivitete të Departamentit Financë Kontabilitet (ndër vite)</i>								
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UAMD e Fakulteti i Biznesit mbështesin dhe nxisin studentët të marrin pjesë në trainime, të nxiten për shfaqjen e ideve inovative, përmes punimeve kërkimore, pjesëmarrjes në konferenca, në aktivitete të përbashkëta me institucione e biznese të sektorit.  GVJ nuk konstatoi ndonjë evidence rreth mbështetjes financiarisht nga institucioni të studentëve.  <i>Evidence 94_Komunikim email Njoftim mbi internship</i> <i>Evidence 44_Njoftim për konkurse, projekte për studentët</i>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi i studimit garanton thellimin e njohurive, dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të tjera.</li> <li>- Syllabuset e lëndëve ofrojnë njohuri të mjaftueshme për të kompletuar studentët me kompetenca në fushën e sigurimeve dhe menaxhimit të riskut.</li> <li>- Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup dhe krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve.</li> <li>- Institucioni duhet të ndjekë politika të qarta dhe të formalizuara të mbështetjes financiarisht të studentëve në punën e tyre kërkimore dhe shkencore.</li> </ul>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet						
			X						

<b>Standardi III.5</b>	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Baza ligjore për saktësimin e detyrimeve përmbyllëse të studentit, pra praktika mësimore dhe diploma apo mikroteza është: Sipas VKM 41, datë 24.01.2018 dhe VKM 879, datë 18.12.2019, nenit 75 të rregullores së UAMD, nenit 68 të rregullores së Fakultetit të Biznesit, nenit 17 të rregullores së programit të studimit.  <i>Evidence 60_VKM nr 41, datë 24.01.2018</i> <i>Evidence 79_VKM 879, datë 18.12.2019 Disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41</i>

	<i>Evidence 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Dokumentohet se UAMD njofton studentët përmes seancave orientuese në auditorë nga pedagogët, nga koordinatorët e programit të studimit, por edhe përmes njoftimeve në faqen e fakultetit për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si gjatë vitit akademik edhe në fund të vitit për detyrimet e tyre përmbyllëse. Veçanërisht për këto procedura bëhet fjalë edhe veprohet në zbatim të rregullores së diplomimit neni 5,6, dhe të rregullores së praktikës mësimore.  <i>Evidence 129_Dosje prezantimi të studentëve Master</i> <i>Evidence 82_Rregullore diplomimi</i>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në UAMD, por edhe për këtë program studimi nuk zhvillohet provim final. Referuar rregullores së diplomimit e planit mësimor, detyrimet përmbyllëse realizohen përmes praktikës mësimore dhe përgatitjes e mbrojtjes së mikrotezës.  <i>Evidencë 83_Rregullore për praktikat mësimore</i> <i>Evidencë 9_Rregullore e programit të Studimit Msc ISDR</i> <i>Evidencë 82_Rregullore diplomimi</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Sipas rregullores së Diplomimit të UAMD e Fakultetit të Biznesit përcaktohen detyrat kryesore të personelit akademik për punimin e diplomës. Njesia bazë miraton temat e mundëshme për t'u pr zgjedhur nga studentët, pedagogët udhëheqës në bashkëpunim me studentët zgjedhin temën që do përgatitet nga student. Pedagogu orienton studentin për strukturën e punimit, për nxjerrjen e rezultateve, formulimin e konkluzioneve e sugjerimeve. Në fund bëhet miratimi e vlerësimi i punimit të diplomës së studentit nga ana e pedagogut, para se të dorëzohet tema në department për evidentim, para mbrojtjes në komision. Caktohen komisionet e mbrojtjes së diplomave nga ana e njesisë bazë, të cilat miratohen nga drejtuesi i njesisë kryesore.  <i>Evidence 82_Rregullore diplomimi</i> <i>Evidence 181_Komunikime me studentët e diplomës Msc ISDR 2021-2022</i> <i>Evidence 181.1_Udhëheqësit shkencorë Master 2021-2022</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	UAMD krijon mundësi për studentët për përgatitjen e detyrave të kursit gjatë vitit, por edhe për përgatitjen e punimit të diplomës, përmes laboratorëve që ka bënë në dispozicion, përmes bibliotekës on line.  <i>Evidence 42_Informacion për Bibliotekën online</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në rregulloret e institucionit, në veçanti në rregulloren e diplomimit, saktësohet se në përfundim të mbrojtjes së diplomës para komisionit studenti vlerësohet me notë. Forma e diplomës dhe suplementi i diplomës janë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.  <i>Evidence 126_Model Procesverbal Praktike dhe Mikroteze</i>

	<i>Evidence 68_Suplement i ri Msc ISDR</i> <i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>		
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	UAMD sipas rregulloreve të miratuara në zbatim të Ligjiit 80/2015, në përfundim të studimeve i pajis studentët me diplomën dhe suplementin e saj, të miratuara nga MAS. Në mënyrë specifike për këtë shprehet rregullore e Sekretarisë Mësimore e Fakultetit të Biznesit, neni 23, 24. Studenti njoftohet të tërheqë diplomën dhe suplementin e diplomës, në përfundim të studimeve.  <i>Evidence 68_Suplement i ri Msc ISDR</i> <i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>		
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UAMD e ka të detyrueshme të ruajë e të arkivojë sipas një afati të caktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet informacione për studentët nëse kërkohet.  <i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidence 82_Rregullore diplomimi</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Kuadri rregullator i UAMD parashikon në mënyrë të detajuar procedurat që ndiqen për përgatitjen për detyrimet përmbyllëse të programit të studimit.</i></li> <li>- <i>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në procesin e përgatitjes së detyrimeve përmbyllëse.</i></li> <li>- <i>Në përfundim të ciklit të studimeve, studenti vlerësohet me notë dhe pajiset me diplomën dhe suplementin e saj.</i></li> <li>- <i>Pranë UAMD dokumentacioni i studentit ruhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.</i></li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b> Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Sipas vizitës në institucion dhe dokumentacionit vënë në dispozicion, UAMD, Fakulteti i Biznesit, Departamenti Financë Kontabilitet kanë në dispozicion të studentëve laboratorë me kompjutera, bibliotekë si fizike dhe on line, mjedise studimi. Sipas marrëveshjeve me institucione e biznese, fakulteti krijon mundësi për përfitime njohurive nga studentët përmes praktikave profesionale, mësimore.

	<i>Evidence 87_Lista me laboratorët Fakulteti Biznesit dhe këndi i studentëve</i> <i>Evidencë 45_Analiza e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamentin Financë Kontabilitet 2022-2023</i>		
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	UAMD përmes marrëveshjeve me partnerët e biznesit ka realizuar ndërtimin e laboratorit me kompjutera për aftësimin e studentëve në lëndë të veçanta aplikative, për vënien në jetë të njohurive e dijeve teorike të marra gjatë zhvillimit të lëndës.  <i>Evidence 87_Lista me laboratorët Fakulteti Biznesit dhe këndi I studentëve</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Sipas planit mësimor të programit tëstudimit, kategoria D është praktika mësimore, e cila vlerësohet me orë dhe kredite. Studenti pasi merr lejen nga fakulteti për zhvillimin e praktikës mësimore në një institucion apo biznes, përgatit një dosje me dokumenta të saktësuar në Rregulloren e praktikës. Dosja miratohet nga pedagogu udhëheqës dhe dorëzohet në department para mbrojtjes. Ditën e mbrojtjes para komisionit, studenti vlerësohet me notë dhe procesverballi dorëzohet në sekretarinë mësimore.  <i>Evidence 81_Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidence 83_Rregullore për praktikrat mësimore</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i>  - <i>Departamenti i Financë Konatbilitetit në bashkëpunim me biznese dhe institucione private e publike garaont ambiente të përshtatshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</i> - <i>Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet në datën e caktuar nga Departamenti dhe komisioni që ai ngre dhe mbart edhe vlerësimin nga drejtuesi në vendin e praktikës.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>				<b>X</b>
---	--	--	--	----------

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr.219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

45

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të dosjes së vetëvlerësimit (RVB) dhe informacionin e marrë në takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna të plota mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi, i cili në përgjithësi është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi sepse sikurse shpjegohet në vijim, në këtë program studimi të ciklit të dytë, janë angazhuar edhe pedagogë që nuk kanë gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Referuar evidencës së tabelave përmbledhëse nr. 6, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike paraqiten si vijon:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 14 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 7 PAE , nga të cilët 1 me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 5 me gradën “Doktor” dhe 1 me Msc,</li> <li>• 7 PAK, nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 4 me gradën “Doktor” dhe 1 me Msc</li> </ul> <p>Referuar ngarkesës mësimore, mbulimi i orëve mësimore në auditor për këtë vit akademik është 43% nga PAE. Llogaritja është bërë në bazë të tabelës nr. 12.1, për të cilën GVJ konstaton se nuk është e plotë (përmban vetëm ngarkesën në orë të 11 lëndëve).</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 18 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 12 PAE , nga të cilët 1 i kategorisë “Profesor i Asociuar” dhe 8 me gradën “Doktor” dhe 3 me Msc,</li> <li>• 6 PAK, nga të cilët 1 me titullin “Profesor” dhe 5 me me gradën “Doktor”.</li> </ul> <p>Referuar ngarkesës mësimore, mbulimi i orëve mësimore në auditor për këtë vit akademik është 64% nga PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022 janë të angazhuar përsëri 17 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 12 PAE , nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 8 me gradën “Doktor” dhe 2 me Msc,</li> <li>• 5 PAK, nga të cilët 2 të kategorisë “Profesor”, 2 me gradën “Doktor” dhe 1 me Msc.</li> </ul> <p>Referuar ngarkesës mësimore, mbulimi i orëve mësimore në auditor për këtë vit akademik është 71% nga PAE.</p>

	<p>Në rastet kur një lëndë është zhvilluar edhe nga personel PAE edhe nga personel PAK, për të llogaritur përqindjen e ngarkesës mësimore, GVJ i ka ndarë orët në mënyrë të barabartë midis tyre.</p> <p>GVJ konstaton se mbulimi i lëndëve të programit të studimit me personel akademik efektiv ka ardhur duke u rritur, si duke iu referuar numrit të personelit akademik PAE edhe ngarkesës mësimore të PAE. Gjithashtu ka mospërputhje në të dhënat e raportuara midis tabelve nr. 6 dhe tabelave nr. 7.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik, GVJ konstatoi se stafi i angazhuar në këtë program studimi ka fushë kërkimore në përputhjen me natyrën dhe veçoritë e lëndëve të ofruara në këtë program studimi.</p> <p>Në funksion të programit të studimit, sikurse edhe për programe të tjera të studimit që ofrohen nga fakulteti, Fakulteti i Biznesit ka angazhuar një personel ndihmës akademik prej 12 anëtarësh, si sekretare dekani, sekretar departamentesh, sekretare mësimore dhe laborant IT. Ky staf ndihmon aktivitetin mësimor dhe kërkimor të departamentit dhe të institucionit në përgjithësi nëpërmjet kryerjes së detyrave të ndryshme për të cilat ka nevojë stafi akademik.</p> <p><i>Evidencë: tabelat Master Shkencor ISDRpdf.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik pranë programit të studimit është realizuar në përgjithësi në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, me përjashtim të tre pedagogëve me Msc.</p> <p>Për vitet akademike 2019-2022, ngarkesa mësimore në këtë program studimi e mbuluar nga personeli akademik efektiv ka ardhur duke u rritur: nga 43% e orëve në auditor në vitin akademik 2019-2020 të mbuluara nga PAE në 71% e orëve në auditor në vitin akademik 2021-2022 të mbuluara nga PAE.</p> <p><i>GVJ konstaton se numri i personelit akademik i kategorisë "Profesor" është i ulët: 2 nga 12 dhe sugjeron zgjerimin e personelit akademik të kësaj kategorie në drejtim të cilësisë së mësimdhënies.</i></p> <p><i>Lidhur me ngarkesën mësimore totale të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, GVJ nuk jep asnjë koment sepse nuk ka të dhëna të raportuara. Por duke iu referuar ngarkesës mësimore të PAE vetëm për programin e studimit, GVJ konstaton se ajo është akoma e ulët, pavarësisht se ka ardhur në rritje nga viti në vit.</i></p> <p><i>Evidencë: tabelat Master Shkencor ISDRpdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 69 Ngarkesa mësimore Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2019-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë shtesë: CV - PAK.pdf</i></p> <p><i>Evidencë shtesë: CV- PAE.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GJV konstatoi qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit dhe Departamentit të Financë Kontabilitetit, si dhe punësimin e tyre pranë UAMD në përgjithësi në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, me përjashtim të personelit akademik të angazhuar me MSC.</p> <p>GJV konstaton se gjatë tre viteve të fundit akademike, të shqyrtuara për akreditim, personelin akademik i angazhuar në këtë program studimi është zgjeruar, dhe në përgjithësi stafi nuk ka ndryshuar - p.sh 85% e stafit akademik efektiv të angazhuar gjatë vitit 2019-2020 ka vazhduar të angazhohet edhe në dy vitet e ardhshme akademike.</p> <p><i>Evidencë: tabelat Master Shkencor ISDRpdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Statuti i UAMD në bazë të legjislacionit në fuqi, përcakton kriteret dhe procedurat që ndiqen në rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë (neni 45), me kohë të pjeshme (neni 46), i ftuar (neni 47) dhe ndihmës akademik (neni 52).</p> <p>Sipas Statutit dhe rregullors së UAMD (Kreu V) përzgjedhja e personelit akademik me kohë të plotë bëhet me konkurrin në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Departamenti në bazë të nevojave të tij, përcakton kriteret specifike për vendet e punës të cilat miratohen nga rektori. Universiteti shpall konkursin për vende të lira pune, sipas strukturës së përgjithshme në nivel institucional, të miratuar nga Bordi i Administrimit dhe kryhet publikimi në Buletinin e Njoftimeve Publike në formë të shkruar dhe elektronike. Gjithashtu, njoftimet publikohen edhe në faqen zyrtare të institucionit, së bashku me formularët e aplikimit.</p> <p>Rekrutimi i personelit kryhet nga një komision i posaçëm me pesë anëtarë, nga të cilët jo më pak se tre përfaqësues të njësisë bazë. Vlerësimi i aplikantëve bëhet në dy faza: vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshkrohen intervistës, sipas një strukture pikësimi të përcaktuar qartë në rregulloren e rekrutimit të personelit akademik.</p> <p>Dosja e aplikantit vlerësohet maksimumi me 70% të totalit të pikëve, ndërsa 30% i pikëve i akordohet intervistës. Komisioni bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve të fituara në total.</p> <p>Rekrutimi i pedagogëve me kohë të pjeshme ndjek të njëjtën procedure si edhe stafi akademik me kohë të plotë.</p> <p>Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik dhe CV e tyre, GJV konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka nivelin e duhur akademik dhe kërkimor shkencor në përputhje me përmbajtjen e moduleve apo lëndëve që ata japin mësim.</p>



	<p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i>  <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në mbështetje të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor-shkencor, institucioni ka angazhuar një staf administrativ dhe ndihmës akademik prej 12 personash në nivel njësie kryesore, të cilët angazhohen në mirëmbajtjen e pajisjeve didaktike, të laboratorëve dhe ambienteve të tjera mësimore.</p> <p><i>Evidencë: tabelat Master Shkencor ISDR.pdf</i>  <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>UAMD sipas organigramës të tij, ka ngritur Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, e cila funksionon në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodin e Punës, Kodin e Procedurave Administrative, Ligjin Nr. 80, datë 22.07. 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe Statutin e UAMD.</p> <p>DBNjJ është e organizuar në tre sektorë, një nga të cilët është Sektori i Burimeve Njerëzore. Sektori i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për realizimin e rekrutimeve për personelin akademik, administrativ dhe ndihmës mësimor – shkencor të institucionit dhe për administrimin e dosjeve të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ shqyrtoi në mënyrë rastësore dosjen personale të dy pedagogëve të programit të studimit dhe konstatoi se dosja ishte e plotësuar me dokumentet e nevojshëm si: CV, vërtetimin nga gjykata, dokumentin e Diplomës, dokumentet e gradave/titujve shkencorë, vërtetime mbi kualifikimin, kontratën e punës, librezën shëndetësore tj.</p> <p><i>Evidencë 180_Rregullore Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Juridike.pdf.pdf</i>  <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale UAMD ka lidhur 61 marrëveshje bashkëpunimi (tabela nr. 5) në nivel institucioni dhe njësie kryesore me përfaqësues të institucioneve publike dhe të bizneseve private, të cilat u mundësojnë edhe realizimin e praktikave profesionale studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Për realizimin e praktikës profesionale studentët asistohen nga Zyra e Karrierës e cila kujdeset për parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave mësimore dhe për orinetimin e tyre në organizatat/kompanitë/institucionet ku do të zhvillojë praktikën.</p>

	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimit, është i angazhuar për të asistuar studentët lidhur me zhvillimin e praktikës profesionale dhe në udhëheqjen e punimit të diplomës.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit parashikon 90 orë në auditor dhe 135 orë jashtë auditorit për realizimin e praktikës profesionale, e cila zhvillohet në semestrin e katërt, me shkëputje nga procesi mësimor.</p> <p><i>Evidencë 27_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 45_Analiza e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 83_Rregullore per praktikat mesimore.pdf</i></p> <p><i>tabelat Master Shkencor ISDRpdf</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale UAMD ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione të ndryshme private dhe publike të cilët u garantojnë dhe ofrojnë mjediset e tyre studentëve për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe asimilimin e njohurive teorike dhe praktike nga studentët e këtij program studimi.</p> <p>Nëpërmjet kontratës që nënshkruhet për zhvillimin e praktikës profesionale të programit të studimit Master i Shkencave ISDR, insitucioni/ndërmarrja ku zhvillohet praktika merr përsipër të asistojë dhe të monitorojë studentin që zhvillon praktikën nëpërmjet angazhimit të një punonjësi të tij; të krijojë kushte lehtësuese për zhvillimin e praktikës, si dhe në përfundim të bëjë një vlerësim me shkrim mbi punën, angazhimin dhe efektivitetin e praktikës profesionale, i cili merret në konsideratë për vlerësimin përfundimtar të praktikës profesionale.</p> <p><i>Evidencë 83_Rregullore per praktikat mesimore.pdf</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi në përgjithësi përmbush kërkesat ligjore në fuqi dhe ka nivelin e kërkuar të kualifikimit akademik për mësimdhënie në programin e studimit, me përjashtim të personelit akademik të angazhuar me Msc.</i></li> <li>- <i>Personeli akademik i Departamentit të Financë Kontabilitetit i angazhuar me kohë të plotë dhe me kontratë në këtë program studimi është i qëndrueshëm.</i></li> <li>- <i>Numri i personelit akademik që i përket kategorisë "Profesor" është i ulët.</i></li> <li>- <i>Ngarkesa mësimore që realizon PAE i angazhuar në programin e studimit është relativisht e ulët, pavarësisht se ka ardhur në rritje nga viti në vit.</i></li> <li>- <i>Pranë Fakultetit të Biznesit angazhohet personel ndihmës i kualifikuar për realizimin e aktiviteteve ndihmëse të procesit akademik.</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit.</i></li> <li>- <i>Marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka nënshkruar me përfaqësues të biznesit dhe institucione private dhe publike, garantojnë infrastrukturën e nevojshme për kryerjen e praktikës profesionale të studentëve të këtij program studimi.</i></li> <li>- <i>Fakulteti i Biznesit ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale dhe ka përgatitur udhëzues për realizimin dhe vlerësimin e praktikës profesionale dhe të temës së diplomës.</i></li> </ul>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> <td></td> </tr> </table>			<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>			<b>X</b>	
		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
		<b>X</b>							

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Sipas RVB aktiviteti mësimor zhvillohet në tre godina: një godinë në Currila dhe dy godina në Spitallë. Gjatë vizitës në Godinën nr. 2 të Kampusit Universitar të Spitallës, ku ushtron aktivitetin Fakulteti i Biznesit, GVJ konstatoi ambjente të mjaftueshme të cilët janë të pajisur me mjetet dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Sipas dokumentacionit bashkëngjitur RVB, veprimtaria e mësimdhënies zhvillohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 16 salla leksioni,</li> <li>• 1 sallë për aktivitete promovuese,</li> <li>• 2 laboratorë informatike,</li> <li>• 1 sallë biblioteke,</li> <li>• zyra për stafin drejtues, personelin akademik dhe ndihmës akademikë, dhe</li> <li>• ambjente të tjera shërbimi në funksion të procesit mësimor dhe punës kërkimore shkencore.</li> </ul> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.</p>
	<p><i>Evidencë 92_Infrastruktura, Planimetria e FB.pdf</i>  <i>Evidencë: tabelat Master Shkencor ISDRpdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe laboratorët, sallën për aktivitete promovuese si konferenca, bibliotekën, zyrat dhe mjediset tjera në shërbim të procesit mësimor dhe vuri re që mjediset mësimore ishin të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së</p>

<p>informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>informacionit si PC, projektorë të lëvizshëm, dhe sistem fonie si dhe kanë ndriçim optimal të cilat mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore mësimore si nga stafi akademik edhe nga studentët.</p> <p><i>Evidencë 92_Infrastruktura, Planimetria e FB.pdf</i>  <i>Evidencë 122_Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në Fakultetin e Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 173_Raporti i AKKSHI për laboratorin e doktoraturës 12.10.2022.pdf</i>  <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sallat ku zhvillohet mësimi i programit të studimit janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si PC, projektorë dhe pajisje fonie e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><i>Evidencë: tabelat Master Shkencor ISDRpdf</i>  <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në Fakultetin e Biznesit ndodhen dy laboratorë informatike, të cilët kanë 80 poste dhe janë të pajisur edhe me programe specifike të fushës së financës si “Financa 5”, “eviews” që përdoren nga studentët në aktivitetin e tyre kërkimor dhe shkencor.</p> <p><i>Në planin mësimor nuk parashikohen orë laboratorike, por studentët frekuentojnë laboratorët për zhvillimin e detyrave/projekteve të kursit dhe punimit të diplomës. Meqënëse programi i studimit përmban lëndë ekonometrike apo lëndë kontabiliteti që kërkojnë përdorimin e programeve specifike në kompjuter, plani mësimor duhet të përfshijë edhe orët laboratorike.</i></p> <p>Me mbështetjen e AKKSHI-t është ngritur edhe laboratori për studimet e doktoraturës i pajisur me pajisjet e duhura duke përfshirë infrastrukturën TIK hardware dhe TIK software si edhe e-infrastrukturën për realizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore. Në këtë laborator janë të instaluar edhe programe antiplagjiaturë dhe programe ekonometrike që do ndihmojnë në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor si të studentëve edhe të stafit akademik.</p> <p><i>Evidencë 122_Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në Fakultetin e Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 173_Raporti i AKKSHI për laboratorin e doktoraturës 12.10.2022.pdf</i>  <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, të cilët pranuar që studentët të zhvillojnë praktika</p>

<p>nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>profesionale pranë tyre, u garantojnë dhe ofrojnë mjediset e tyre për realizimin e praktikave profesionale të studentëve.</p> <p><i>GVJ konstaton se pjesa më e madhe e marrëveshjeve janë lidhur me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Me qëllim ofrimin e alternativave të ndryshme të kryerjes së praktikës mësimore pranë bizneseve, GVJ sugjeron që institucioni të rritë numrin e marrëveshjeve vecanërisht me njësi biznesi dhe institucione financiare.</i></p> <p>Praktika profesionale zhvillohet gjatë semestrit të katërt me shkëputje nga procesi mësimor në mjediset e institucionit pritës sipas kontratës për praktikën profesionale të miratuar nga palët.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.22 Lista e marrëveshjeve 2022 .pdf</i>  <i>Evidencë nr. 3.6.1 Kërkesa dhe Kontrata për Praktikë Profesionale në MP_FB.pdf</i></p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>UAMD siguron ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore.</i></li> <li>- <i>Ambjentet mësimore dhe mjediset e tjera ndihmëse janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i></li> <li>- <i>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe speciale për fushën e financës, antiplagjiaturë dhe ekonometrike, si dhe ambiente të tjera në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor.</i></li> <li>- <i>UAMD garanton zhvillimin e praktikës profesionale dhe veprimtarive të tjera profesionale në mjedise të përshtatshme nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura me institucione dhe subjekte të tjera.</i></li> </ul>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstatoi se në pothuajse të gjitha lëndët ofrohet literature bërë dhe e rekomanduar, në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj. Kjo literature gjendet në formë fizike dhe/ose digjitale pranë bibliotekës së universitetit. Përveç literaturës së cituar në syllabuset e lëndëve, gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se pedagogët vënë</p>

<p>parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>në dispozicion të studentëve përmbledhje me slide apo ushtrime dhe raste studimore për lëndët përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022.pdf</i>  <i>Evidenca shtesë të kërkuara jatë vizitës në intitucion:</i>  <i>Syllabuse - v.a 2021-2022 (Msc. ISDR).pdf</i>  <i>Syllabuse - v.a. 2022-2023 (Msc.ISDR)2.pdf</i>  <i>Vizita në Intitucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Sipas RVB, por edhe gjatë vizitës, drejtuesit e institucionit u shprehën se anagzhohen në përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. Por në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, dhe nga shqyrtimi i literaturës së syllabuseve, GVJ konstaton se në përgjithësi literatura në sillabuse nuk është e përditësuar.</p> <p><i>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, GVJ konstaton se nuk ka informacion të përditësuar mbi pasurimin me tituj të rinj të viteve të fundit të bibliotekës, dhe në veçanti në lidhje me programin e studimit. Dokumenti i vënë në dispozicion të RVB mbi blerjet e librave për bibliotekën përmban të dhëna deri në vitin 2016 dhe për donacionet deri në vitin 2019. Përditësimi i literaturës nga institucioni është kryer nëpërmjet rregjistrimit në platforma elektronike.</i></p> <p><i>Evidencë 182_Informacion për Bibliotekën mbi evidencat për akreditimin institucional.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 110_Memo propozim per blerje librash.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët e programit të studimit kanë në dispozicion bibliotekën shkencore të UAMD. Biblioteka ushtron aktivitetin e saj në bazë të rregullores në lidhje me regjistrimin e materialeve bibliotekare, sigurimin e informacionit për përdoruesit nëpërmjet skedareve, krijimin dhe mirëmbajtjen e katalogut online dhe arkives dixhitale pasurimit nëpërmjet, blerjeve, dhuratave, projekteve dhe shkëmbimit, vënies në shërbim të lexuesve koleksionet e bibliotekës në sallat e leximit ose huazimit të tyre, plotësimin të kërkesave të lexuesve, ku janë depozituar edhe tekset dhe materialet mësimore të programit të studimit etj. Rregullorja përcakton dhe të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të bibliotekës duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të punojnë në bibliotekë ose të marrin materialet, kundrejt anëtarësimit me kartelë identifikimi dhe pa pagesë.</p> <p><i>Evidencë 109_Rregullorja e Bibliotekes.pdf</i>  <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të</p>	<p>Nga vizita në këtë bibliotekë, si dhe informacioni paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të UAMD si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe;</p>

<p>nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, periodikë, monografi, revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidencë 182_Informacion për Bibliotekën mbi evidencat për akreditimin institucional.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Përveç literaturës fizike që gjendet në ambjentet e bibliotekave, studentët kanë mundësi të përdorin pa pagesë edhe bibliotekat online të ofruara nga institucioni. Institucioni ka vënë në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve disa platforma online si: u-Library, Cobiss, Koha Jstore etj. ku ata kanë akses në literaturë në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj.</p> <p><i>Evidencë 40_Abonim në librarinë digjitale JSTOR në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD-së dhe AADF.pdf</i> <i>Evidencë 41_Lista E-books e disponueshme.pdf</i> <i>Evidencë 42_Informacion për Bibliotekën Online.pdf</i> <i>Evidencë 110_Memo propozim per blerje librash.pdf</i> <i>Evidencë 123 _ Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Sipas dokumentacionit shoqëruar të RVB, biblioteka universitare ushtron aktivitetin në 3 godina të ndryshme. GVJ vizitoi ambjentet e Bibliotekës Nr. 2 (220 m<sup>2</sup>), pranë kampusit universitar, që i shërben Fakultetit të Biznesit dhe Fakultetit të Edukimit. Salla e bibliotekës ka internet dhe është e pajisur me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën elektronike.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ iu konfirmua se biblioteka frekuentohej vazhdimisht nga studentët jo vetëm për të tërhequr libra apo materiale mësimore por edhe si sallë studimi/leximi.</p> <p><i>Evidencë 103_Të dhënat për bibliotekën.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i shërbimit fizik të bibliotekës është i përshtatur me orarin e zhvillimit të procesit mësimor në UAMD. Përveç ditëve të javës, institucioni ka marrë masa që biblioteka të jetë e hapur për studentët edhe gjatë ditëve të fundjavës.</p> <p><i>Evidencë 120_Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ dhe sipas RVB, konfirmohet angazhimi i institucionit për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me tituj të rinj në mbështetje të të gjithë programeve të studimit. Institucioni ka hartuar një relacion mbi veprimtarinë e bibliotekës së UAMD, politikat që ndjek për pasurimin e saj, fondin fizik dhe elektronik, por GVJ konstaton se ky informacion nuk është i përditësuar. Sipas RVB personeli akademik në bashkëpunim me drejtuesit e strukturave hartojnë çdo vit plane për të</p>

fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<p><i>shtuar literaturën e bibliotekës çdo vit akademik. Por në bazë të dokumentave shoqërues të RVB, GVJ nuk konstaton që këto plane të kryhen periodikisht, dhe në veçanti nga Departamenti i Financë Kontabilitetit, sikurse raportohet në RVB. Gjithashtu duke iu referuar edhe buxhetit të institucionit është parashikuar buxheti për bibliotekat online por jo për pasurimin fizik të bibliotekës</i></p> <p><i>Evidencë 103_Të dhënat për bibliotekën.pdf</i>  <i>Evidencë 110_Memo propozim per blerje librash.pdf</i>  <i>Evidencë 117_Projektbuxheti 2021-2022 Dep. FK.pdf</i></p>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Literatura bazë dhe ndihmëse në përgjithësi është në përputhje me programin e studimit, syllabuset dhe mundëson arritjen e objektivave të tij.</i></li> <li>- <i>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën me tituj fizikë dhe disa platforma online, duke mundësuar akses dhe shfrytëzim optimal të literaturës së ofruar.</i></li> <li>- <i>Institucioni duhet të angazhohet më shumë në pasurimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të bibliotekës fizike dhe online me tituj të rinj.</i></li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht
		<b>X</b>	

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Administrimi i informacioni lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre menaxhohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Strukturavë të ngritura në organikën e UAMD: Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akadematike, dhe Sekretaria e Fakultetit të Biznesit, si edhe zyra të tjera që bëjnë administrimin e informacionit, të cilat funksionojnë në bazë të rregulloreve përkatëse, dhe</li> <li>• Online përmes sistemit të menaxhimit elektronik të informacionit “Pitagora”.</li> </ul> <p><i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarise Mesimore ne FB.pdf</i>  <i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akadematike.pdf</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Administrimi i informacionit dhe dokumentacionit të personelit akademik, personelit ndihmës-akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit realizohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit, përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>Sektori i Burimeve Njerëzore, si është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, sipas rregullores përkatëse (neni 7) përgjigjet për plotësimin e dosjes personale me dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës të institucionit dhe mban (në kartotekë) dokumentacionin e plotë dhe të rregullt të tij.</p> <p>Dokumentacioni kërkimor dhe shkencor lidhur me personelin akademik administrohet dhe përditësohet nga departamenti i Financë Kontabilitetit.</p> <p><i>Evidencë 180_Rregullore Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Juridike.pdf.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit menaxhohet nga zyrat përkatëse dhe siguron akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit e tij. Informacioni është i disponueshëm për të gjithë personelin dhe studentët në forma të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në rrugë elektronike nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të institucionit, nëpërmjet sistemit Pitagora ku studentët mund të logohen me anë të një user name personal dhe passëordi dhe të marrin informacion mbi vlerësimin e vazhdueshëm dhe përfundimtar të çdo lënë, si dhe nëpërmjet ëbsitet personal (klasën virtuale) të çdo pedagogu ku mund të konsutojnë materialet lidhur me procesin mësimor.</li> <li>• Nëpërmjet zyrave përkatëse të institucionit përgjegjëse për administrimin dhe ruajtjen e informacionit, kundrejt miratimit nga institucioni të kërkesës të të interesuarve (personeli dhe studentët).</li> </ul> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 121_Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi në takimet me stafin akademik dhe studentët se platforma Pitagora, garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë UAMD. Nëpërmjet kësaj platforme studentët kanë mundësi të aksesojnë në distancë çdo informacion lidhur me frekuentimin dhe vlerësimin në çdo lëndë të programit të studimit.</p> <p>Për procesin e mësimdhënies dhe mësimnxësis, personeli akademik përdor edhe platformat online Google Classroom dhe Teams. Kjo platformë është përdorur jo vetëm për të zhvilluar mësimin gjatë periudhës së zhvillimit të mësimin on-line, por përdoret aktualisht nga personeli</p>

	<p>akademik për të komunikuar me studentët dhe për të shkëmbyer informacion mbi lëndët, dhe materialet mësimore.</p> <p><i>Evidencë 121_ Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).pdf</i>  <i>Evidencë 90_Raport monitorimi te mesimit online_Rezultate Teams.pdf</i>  <i>Evidencë 66_Metodat interaktive të përdorura për mësimdhënie përfundimtare, shkurt 2023.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Aktet rregullatore të institucionit sigurojnë monitorimin e aktivitetit akademik e administrativ. Aktiviteti mësimor monitorohet nëpërmjet rregjistrimit mësimor i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga pedagogu i lëndës. Në rast mungese bëhet njoftimi i drejtuesve në bazë të rregullores. Aktiviteti i sekretarisë mësimore mbikqyret nga Zv/dekalni për anën mësimore dhe realizohet në bazë të rregullores së fakultetit dhe rregullores së sekretarisë mësimore.</p> <p>GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të UAMD bëhet në mënyrë të dokumentar duke respektuar aktet rregullatore të institucionit dhe garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarise Mesimore ne FB.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacioni në faqen zyrtare të internetit të UAMD është i aksesueshëm në gjuhën shqipe, në gjuhën angleze dhe në gjuhën italiane.</p> <p><i>GVJ konstaton se institucioni publikon vazhdimisht informacion mbi aktivitete të ndryshme që lidhen me studentët, por konstaton se informacioni nuk është lehtësisht i aksesueshëm dhe në disa raste mungon.</i>  <a href="https://www.uamd.edu.al/fea">https://www.uamd.edu.al/fea</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni ka integruar disa platforma për administrimin e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë UAMD.</i></li> <li>- <i>Sistemi i menaxhimit të informacionit i dokumentuar fizikisht siguron, nëpërmjet zbatimit të kuadrit rregullator të UAMD monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit.</i></li> <li>- <i>Institucioni publikon në faqen e tij zyrtare të internetit informacion në gjuhën shqipe, angleze dhe italiane, por informacioni duhet të jetë më i strukturuar që të jetë lehtësisht i aksesueshëm, dhe i plotë.</i></li> </ul>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet mësimisht</p> <p>Përmbushet kryesisht</p> <p>Përmbushet plotësisht</p>

			X	
--	--	--	---	--

**Standardi IV.5**

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, si dhe në informacionin e marrë në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të kostove të njësisë bazë sipas programeve apo cikleve të studimit, por vetëm në nivel fakulteti/universiteti. Sipas RVB në kuadër të riorganizimit të programit të studimit Departamenti i Financë Kontabilitetit ka llogaritur të ardhurat nga tarifat e studentëve bazuar në numrin e lëndëve, krediteve dhe numrin e studentëve, cili është parashikuar të jetë më i lartë nga sa është aktualisht.</p> <p><i>Evidencë 117_Projektbuxheti 2021-2022 Dep. FK.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Sipas statutit, UAMD financohet nga buxheti i shtetit, pagesat e studentëve për arsim, të ardhurat për shërbimet e kryera, të ardhurat nga marrëdhëniet me palët e treta, donacione, verimtare kërkimore dhe projekte (neni 96).</p> <p><i>Të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konferencat administrohen sipas një rregulloreje të veçantë, të propozuar nga Senati dhe të miratuar nga Bordi i Administrimit (neni 95 i Statutit). GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të RVB nuk konstaton ekzistencën e një rregulloreje të tillë.</i></p> <p>Sipas RVB buxhetet e miratuara nga çdo njësi bazë, kalojnë për miratim në njësinë kryesore dhe më pas në rektorat. Në vijim ky buxhet diskutohet dhe miratohet në mbledhjet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.</p> <p><i>Projekt buxheti 2021-2022 që është pjesë e dokumentacionit të RVB, të cilit RVB i referohet si një plan financiar i hartuar nga departamenti i Financë-Kontabilitetit nuk është i qartë. GVJ konstaton se nuk i takon vitit akademik 2021-2022 (sikurse emërtohet në evidencën nr. 117), por është një plan-buxhet për vitet 2023-2025. Gjithashtu evidenca nuk është e qartë nëse i përket planbuxhetit të Fakultetit të Biznesit (sikurse emërtohet në krye të tabelave përkatëse) apo nëse i përket departamentit të Financë-Kontabilitetit (sikurse emërtohet evidence përkatëse).</i></p> <p><i>Ne faqen e internetit të institucionit, jepet informacion mbi buxhetet (plan dhe fakt) por GVJ konstaton se ky informacion nuk publikohet në mënyrë periodike.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon hartimin e raporteve vjetore në nivel njësie bazë/kryesore dhe institucioni mbi realizimin e të ardhurave vjetore dhe shpenzimin e tyre në mënyrë që të bëhen analizat përkatëse për përmirësimin e treguesve financiarë. Meqënëse numri i studentëve në</i></p>

	<p><i>programin e studimit është i ulët, do të ishte mirë që të llogaritej një kosto e tij, sepse sipas RVB numri prej 40 studentëve të marrë në konsideratë për të llogaritur të ardhurat nga tarifat është shumë i lartë. Gjithashtu, aktet rregullatore të institucionit duhet të parashikojnë hapat që ndiqen në hartimin e projekt buxhetit në mënyrë që të përfshihen të gjitha njësitë përbërëse të UAMD.</i></p> <p><i>Evidencë 117_Projektbuxheti 2021-2022 Dep. FK.pdf</i>  <a href="https://ëëë.uamd.edu.al/fea">https://ëëë.uamd.edu.al/fea</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në nenin nr. 102 të statutit të UAMD, kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UAMD dhe në njësitë përbërëse të tij realizohet nga njësitë e auditimit të brendshëm, krijimi i të cilave bëhet me vendim të Bordit të Administrimit. Sipas RVB, UAMD kryen auditimin e brendshëm sipas procedurave ligjore.</p> <p><i>Institucioni ka hartuar Kartën e Auditit të Brendshëm e cila miratohet nga Bordi i Administrimit, por GVJ konstaton se është një dokument pa firmë, vulë dhe pa datë miratimi.</i></p> <p><i>Evidencë 118_Raporti Vjetor i Auditit të brendshëm (Karta auditit të brendshëm, pyetësi i vetvlerësimit të AB raporti vjetor, formati i raportimit 2020).pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare në mbyllje të një cikli të plotë studimi dy vjeçar. Sipas RVB në raportin vjetor të UAMD të prezantuar nga Rektori para Senatit, Bordit të Administrimit, stafit akademik dhe administrativ dhe studentëve, bëhet një analizë e gjendjes financiare të institucionit. <i>Sipas RVB ky raport bëhet publik në faqen zyrtare të institucionit nën rubrikën "vendime". Nga shqyrtimi i kësaj rubrike GVJ konstaton se të aksesueshëm janë vetëm vendimet e vitit 2023, ndërsa vendimet e mëparshme nuk janë të aksesueshme në faqen e internetit. Gjithashtu, është shumë e vështirë të kërkosh një vendim për një tematikë të caktuar, sepse në emërtim jepet vetëm numri i vendimit dhe jo emërtimi i tij.</i></p> <p><i>Evidencë 156_Mbledhje e Përbashkët Senati Akademik, Bordi i Administrimit.pdf.pdf</i>  <a href="https://www.uamd.edu.al">https://www.uamd.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të</p>	<p>UAMD është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".</p> <p>Sipas kuadrit rregullator në fuqi, burimet e financimit të UAMD janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;</p>

<p>situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore. Fondet e buxhetit të shtetit në përputhje me udhëzimet e MFE shpërndahen në formë granti për politikën e zhvillimit të UAMD, për mësimdhënien dhe për punën kërkimore-shkencore e veprimtaritë krijuese. Përdorimi i fondeve publike nga UAMD bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.</p> <p>Referuar tabelës nr. 18:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për vitin akademik 2019-2020 të ardhurat totale kanë qenë 1.082.354.067 lekë, nga të cilat 83,4% kanë ardhur nga buxheti i shtetit;</li> <li>• për vitin akademik 2019-2020 të ardhurat totale kanë qenë 1.076.144.918 lekë, nga të cilat 76% kanë ardhur nga buxheti i shtetit;</li> <li>• për vitin akademik 2019-2020 të ardhurat totale kanë qenë 1.133.710.586 lekë, nga të cilat 82,4% kanë ardhur nga buxheti i shtetit.</li> </ul> <p><i>Nga shqyrtimi i informacionit mbi buxhetin paraqitur në faqen zyrtare të internetit të institucionit (ku jepet informacion vetëm për muajt djator 2022, janar dhe shkurt 2023), GVJ konstaton se nuk është akorduar asnjë fond për pasurimin e titujve të bibliotekës dhe vlera e akorduar për kërkimin shkencor nga fondet e universitetit në muajin shkurt është përdorur në masën 10%. Ndërsa në një dokument tjetër të emërtuar "Raporti financiar për shpenzime dhe të ardhura të realizuara për vitin 2021-2022" shpenzimet për kërkimin shkencor përbjnë rreth 1,3% të totalit të shpenzimeve vjetore.</i></p> <p><i>GVJ sygjeron që institucioni duhet të jetë transparent lidhur me planet financiare dhe buxhetin. Informacioni duhet të publikohet në mënyrë periodike dhe të jetë i mirëorganizuar dhe lehtësisht i aksesueshëm nga palët e interesuara.</i></p> <p><i>Evidencë 117_Projektbuxheti 2021-2022 Dep. FK.pdf</i>  <i>tabelat Master Shkencor ISDR.pdf</i>  <i>Evidencë 113_Miratimi i Buxhetit Vjetor 2020-2021.pdf</i>  <i>Evidencë 97_Raporti financiar per shpenzime dhe te ardhura te realizuara per v.a. 2021-2022.pdf</i>  <a href="https://www.uamd.edu.al">https://www.uamd.edu.al</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UAMD funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015. GVJ rekomandon plotësimin e kuadrit rregullator të institucionit mbi administrimin e të ardhurave të veta (sikurse përcakton edhe Statuti i institucionit).</li> <li>- UAMD harton projekt buxhete në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel fakulteti/universiteti, por GVJ nuk konstaton</li> </ul>

	<p><i>ndonjë raport/analizë financiare mbi realizimin e zërave buxhetorë. Institucioni duhet të mbështesë me më shumë fonde kërkimin shkencor dhe bibliotekën.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në varësi të Bordit të Administrimit të UAMD.</i></li> <li>- <i>UAMD si institucion buxhetor, i financuar kryesisht nga të ardhurat publike, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit. Në kuadrin e transparencës, UAMD duhet të publikojë periodikisht buxhetin e tij.</i></li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>			X	
--	--	--	---	--

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, në statutin dhe rregulloren e universitetit përcaktohen qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve. Kushtet e pranimit, regjistrimit të studentëve, përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat e tyre gjatë ciklit akademik, kontrolli i dijeve, transferimi, pezullimi dhe rifillimi i programit të studimit dhe deri tek diplomimi përcaktohen në Kapitullin IX të statutit, dhe në Kreun III (Organizimi i studimeve) të rregullores së universitetit, si edhe në rregulloren e Fakultetit të Biznesit, rregulloren e departamentit dhe në mënyrë më të detajuar në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe në bazë të dokumentacionit të RVB, GVJ konstaton se pranimi në këtë program studimi është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i>  <i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>

	<p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i>  <i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit garantoohen nëpërmjet akteve rregullatorë të institucionit dhe zbatohen në të njëjtën mënyrë për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i>  <i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i>  <i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se sikurse përcaktohet edhe në rregulloren e programit të studimit (neni 9), pranimi në programin e studimit është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë.</p> <p>Kuotat dhe kriteret e pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve fitues propozohen nga Departamenti i Financë Kontabilitetit (sikurse dokumentohet nga evidence nr. 65), miratohen nga Dekani dhe i përcillen Senatit Akademik, i cili miraton propozimin dhe ka për detyrë t'ia përcjellë MAS-it dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore para fillimit të aplikimeve për pranime.</p> <p>Njësia kryesore ka për detyrë të bëjë publike kuotat dhe kriteret e përcaktuara nga departamentet për të gjitha programet e studimit që ofron. Si rregull, këto kritere nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja. UAMD mund të vendosë edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen publikisht përpara fillimit të aplikimeve. Kriteret shtesë vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Kriteret e miratuara nga Senati Akademik bëhen publike nga njësia kryesore dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore përpara fillimit të aplikimeve për pranime. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i Shkencave" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të BE.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut.pdf</i>  <i>Evidencë 65_Kritere Pranimi programet e studimit ndër vite.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë</p>	<p>Aktet rregullatore të UAMD dhe në veçanti rregullorja e programit të studimit përcakton qartë kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, shkëmbimit të studentëve, pranimin e</p>

<p>kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>studentëve të huaj dhe të transferuar, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, frekuentimit të lëndëve dhe të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Një pjesë e tyre si për shembull kriteret e pranimit të programin e studimit, janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të insitucionit, duke qenë të aksesueshme nga publiku.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i>  <i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut.pdf</i>  <a href="https://www.uamd.edu.al">https://www.uamd.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kriteret për ndjekjen e programit të studimit dhe përmbajtja e tij bëhen publike për të gjithë të interesuarit përmes publikimit të tyre në faqen zyrtare të institucionit dhe në rrjetet sociale. Informimi realizohet edhe në ambjentet e UAMD, nëpërmjet afishimit të kriterëve në stendat e universitetit.</p> <p>Për vitin akadmeik 2023-2024, pranimi bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe përzgjedhja e kandidatëve bëhet në bazë të notës mesatare gjatë studimeve bachelor.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i>  <i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut.pdf</i>  <i>Evidencë 65_Kritere Pranimit programet e studimit ndër vite.pdf</i>  <a href="https://www.uamd.edu.al">https://www.uamd.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, GVJ konstaton se për këtë program studimi për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, zbatohen të njëjtat kritere si edhe për aplikantët e tjerë. Megjithatë, UAMD ka hartuar një rregullore të brendshme mbi “Trajtimin e studentëve me aftësi të kuafizuara në UAMD” e aksesueshme në faqen zyrtare të internetit të institucionit.</p> <p><i>GVJ nuk konstaton ndonjë dokument ku të përcaktohen kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta. Për këtë arsye rekomandon që në politikat e përzgjedhjes së studentëve për kandidatët me aftësi të veçanta dhe nga shtresat në nevojë të aplikohen kritere të vecanta dhe jo të njëjta me studentët e tjerë.</i></p> <p><i>Evidencë 125_Komunikim per njoftim nga Dekanti per kuota dhe kriteret.pdf</i>  <i>Evidencë 145_Përcjellja e kuotave_Rektori.pdf</i>  <i>Evidencë 151_Kuotat e pranimit UAMD, v.a 2022-2023.pdf</i>  <i>Evidencë 65_Kritere Pranimit programet e studimit ndër vite.pdf</i></p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Sipas RVB njësia bazë harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e e kandidatëve nga shtetet e tjera dhe aplikon të njëjtat kriteret për aplikantët brenda vendit dhe kandidatët nga shtete të huaja.</p> <p><i>Në rregulloren e Fakultetit të Biznesit (neni nr. 37) parashikon pranimin e shtetasve të huaj në programet e ciklit të parë të studimeve, por neni 29 i kësaj rregullore nuk parashikon asnjë përcaktim mbi pranimet e shtetasve të huaj në programet e ciklit të dytë të studimeve.</i></p> <p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të RVB, GVJ konstaton se institucioni parashikon kuota për kandidatë me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtetasve të marginalizuara, por nuk parashikon kuota për shtetas të huaj.</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 65_Kritere Pranimi programet e studimit ndër vite.pdf</i>  <i>Evidencë 151_Kuotat e pranimit UAMD, v.a 2022-2023.pdf</i></p>						
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Referuar RVB, institucioni bazohet në udhëzimet dhe vendimet e qeverisë për politikën e ndihmës/bursave për shtresa në nevojë.</p> <p><i>GVJ nuk konstaton që kjo politikë të përfshihet në aktet rregullatore të institucionit dhe programit të studimit dhe nuk ka ndonjë evidencë mbi akordimin e tyre.</i></p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve të programit të studimit, janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe statutin e UAMD.</i></li> <li>- <i>Kriteret dhe kuotat e pranimit, pas marrjes së miratimit sipas kuadrit rregullator, bëhen publike nga UAMD përpara fillimit të aplikimeve për pranimet në ciklin e dytë të studimeve.</i></li> <li>- <i>Institucioni nuk parashikon në aktet rregullatore të tij kriteret e veçanta për shtresa në nevojë, persona me aftësi të veçanta dhe shtetas të huaj, por në këtë drejtim zbaton aktet ligjore.</i></li> </ul>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

**Standardi V.2**

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>UAMD vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren e universitetit (nenet 66 dhe 68), Fakultetit të Biznesit (nenet 46, 57 dhe 59), dhe në mënyrë më të detajuar në rregulloren e programit të studimit (nenet 9, 13 dhe 14).</p> <p>Studentët vihen në dijeni mbi këto kritere dhe procedura edhe nga personeli akademik gjatë orës së parë të mësimit, kur bëhet prezantimi i lëndës.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i>  <i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit (neni 10) procedurat për transferimin e studimeve kryhen në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë së fundi i javës së dytë të semestrit të parë. Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në këtë program studimi, bëhet nga Departamenti Financë-Kontabilitet, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloret e UAMD.</p> <p>Lënda ose moduli në këtë program studimi ekuivalentohet kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ka emërtim të njëjtë ose të ngjashëm me lëndën/modulin e programit të studimit ku transferohet;</li> <li>• trajton tema të njëjta ose të ngjashme dhe ka përputhje të ngarkesës në auditor në masën mbi 70% të lëndës / modulit që zhvillohet në programin e studimit.</li> </ul> <p>Studenti mund të transferojë studimet, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda fakulteti apo nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ka grumbulluar, sipas formulës së pranimit në programin përkatës të studimit, sasi pikësh më të larta se pragu minimal i pikëve, që është arritur në programin e studimit të kërkuar në vitin përkatës;</li> <li>• ka fituar jo më pak se 30 kredite në programin përkatës të studimit, nga vjen;</li> <li>• plotëson kriteret specifike për transferimin e studimeve të përcaktuara nga Departamenti Financë-Kontabilitet.</li> </ul> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e Fakultetit të Biznesit (neni 59) dhe në</p>

<p>afësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>rregulloren e programit të studimit (neni 14 dhe Aneksi nr. 4) dhe në përgjithësi në syllabuset e çdo lënde.</p> <p>Studenti fiton të drejtën të hyjë në provimin e një lënde kur ka shlyer të gjitha detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor, si dhe kur nuk ka detyrime financiare ndaj Universitetit "Aleksandër Moisiu".</p> <p>Në këtë program studimi për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor të lëndës vlerësohet me një sistem pikëzimi 1 000 pikësh, i cili konvertohet në notë në procesverbalin përfundimtar.</p> <p>Nga verifikimi i syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve të studentëve kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyra, projekte, ese – 10% të vlerësimit total;</li> <li>• Provim i ndërmjetëm – 40% të vlerësimit total;</li> <li>• Provimit përfundimtar - 50% të vlerësimit total.</li> </ul> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se studentët njihen me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve nga stafi akademik i cili bën prezantimin e lëndës gjatë orës së parë të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut.pdf</i>  <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen pothuajse në të gjitha aktet rregullatore të UAMD: rregullorja e universitetit (nenet 75 dhe 76), rregullorja e Fakultetit të Biznesit (nenet 66 dhe 67) dhe rregullorja e programit të studimit (nenet 17 dhe 18).</p> <p>Studimet e ciklit të dytë përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë Master i Shkencave në "Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut". Studenti nuk mund të mbrojë tezën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit.</p> <p>Teza e diplomës së ciklit të dytë të studimeve është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti apo studimi</p> <p>UAMD ka hartuar një rregullore për punimin e diplomës nëpërmjet të cilit studentët udhëzohen për hapat që duhet të ndjekë nga kërkesa për temën e diplomës pranë sekretarisë, zgjedhja e temës së diplomës, procedura për shkrimin e punimit të diplomës dhe prezantimi përpara komisionit të diplomës.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>

	<p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut.pdf</i>  <i>Evidencë 82 Rregullore Diplomimi.pdf.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se informimi i të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit bëhet nëpërmjet takimeve të hapura në auditorë dhe nëpërmjet publikimit të informacionit në faqen zyrtare të institucionit dhe në rrjetet sociale.</p> <p><a href="https://www.uamd.edu.al">https://www.uamd.edu.al</a></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UAMD vë në dispozicion të studentëve informacionin mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh.</li> <li>- UAMD vë në dispozicion të studentëve informacionin mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në programin e studimit, përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.</li> <li>- Intitucioni organizon takime informuese dhe publikon informacione për palët e interesuara për programin e studimit.</li> </ul>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

<p><b>Standardi V.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit përmes faqes zyrtare të internetit të UAMD, rrjeteve sociale, informacionit që marrin nga sekretaria mësimore që në momentin e aplikimit apo rregjistrimit dhe vënia në dispozicion e dosjes së programit të studimit, si dhe nga stafi akademik gjatë javës së parë të fillimit të vitit akademik.</p> <p><a href="https://www.uamd.edu.al">https://www.uamd.edu.al</a>  Vizita në Institucion</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për</p>	<p>Studentët e programit të studimit kanë mundësi të marrin informacion lidhur me modulet dhe përmbajtjen e programeve të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përmes faqes zyrtare online të institucionit dhe rrjeteve sociale;</li> <li>• përmes informimit nga zyra e sekretarisë;</li> </ul>

<p>lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• përmes prezantimit nga stafi akademik të syllabuseve të lëndëve mësimore, gjatë orës së parë të mësimit ku marrin informacione të detajuara mbi objektivat e lëndës, aftësitë dhe kompetencat e synuara, ngarkesën mësimore, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, kërkesat për frekuentimit të lëndës, si dhe literaturën bazë dhe të rekomanduar;</li> <li>• përmes afishimeve në mjediset e UAMD.</li> </ul> <p><a href="https://www.uamd.edu.al">https://www.uamd.edu.al</a> Vizita në Institucion</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni dhe në veçanti Departamenti i Financë Kontabilitetit që është përgjegjës për këtë program studimi i mbështet studentët në orientimin e tyre drejt tregut të punës duke organizuar vazhdimisht takime me drejtues të institucioneve/bizneseve të ndryshme në vend, në bazë të marrëveshjeve që UAMD ka lidhur me biznese dhe institucione publike për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve, të cilat ndihmojnë për një qasje sa më të mirë të studentëve me tregun e punës.</p> <p>Në UAMD është ngritur zyra e Alumnit dhe Karrierës që ka për detyrë informimin dhe këshillimin e studentëve lidhur me mundësitë e punësimit dhe karrierën e tyre dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve në panairin e punës dhe karrierës të organizuar nga UAMD.</p> <p><i>Evidencë 134_Komunikim me emaile per praktika pune_Banka Intesa San Paolo.pdf</i> <i>Evidencë 136_Panairi i Punes Njoftime.pdf</i> <i>Evidencë 137_Komunikim me emaile per praktika pune.pdf</i> <i>Evidencë 152_Pyetësor mbi rrjetin Alumni dhe Panairin e Punës &amp; Karrierës.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë javës së parë të fillimit të vitit akademik, studentët informohen mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p>Ky informacion mund të sigurohet nëpërmjet stendave dhe sinjalistikës orientuese brenda ambienteve të fakultetit si edhe nga publikimi i informacionit online.</p> <p><a href="https://www.uamd.edu.al">https://www.uamd.edu.al</a> Vizita në Institucion</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Përveç takimeve të drjtëpërdrejta që studentët kanë mundësi të kryejnë me drjtuesin e deprtamentit, koordinatorin e programit të studimit dhe sekretarinë, ata kanë mundësi të aksesojnë në distancë çdo informacion lidhur me frekuentimin dhe vlerësimin në çdo lëndë të programit të studimit nëpërmjet përdorimit të sistemit Pitagora.</p> <p><i>Evidencë 191_Urdhër ngritje grupi pune për Pitagora dhe MOODLE datë 23.10.2020.pdf</i></p>

	<i>Evidencë 121_ Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).pdf</i>		
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UAMD informon studentët mbi logjistikën, infrastrukturën e institucionit, strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Informimi realizohet përmes takimeve, vënies në dispozicion të studentëve të dosjes të programit të studimit, si dhe publikimit të informacionit në ambientet e institucionit dhe në faqen zyrtare të internetit.</li> <li>- Institucioni, nëpërmjet strukturave që ka ngritur, informon studentët mbi mundësitë e punësimit të tyre dhe zhvillon aktivitete në bashkëpunim me institucione dhe biznese për orientimin e tyre drejt tregut të punës.</li> <li>- Sistemi i menaxhimit të informacionit është funksional dhe lehtësisht i aksesueshëm në çdo kohë nga studentët dhe personeli akademik dhe administrativ.</li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profillin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>UAMD në organigramën e tij ka ngritur Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, e cila ushtron veprimtarinë në bazë të rregullores së saj, në përputhje me me legjislacionin në fuqi dhe kudrin rregullator të UAMD. Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p> <p>Në mënyrë më specifike (neni 17), Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, pjese e kësaj drejtorie mbledh databazave të studentëve aktualë dhe studentëve të diplomuar nga kryesekretaret e secilit fakultet, kryen përpunimin statistikor të tyre dhe përditësimin e të dhënave, hartimin e tabelave statistikore mbi numrin e studentëve me bursë dhe atyre me ndihmë ekonomike, përpunimin e të dhënave statistikore mbi studentët inaktivë dhe të çrregjistruar, hartimin e tabelave statistikore për çdo vit të ri akademik mbi realizimin e kuotave, aplikimet dhe rregjistrimet e studentëve të vitit të parë dhe notën mesatare në hyrje etj.</p>

	<i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i>																
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, larguar, transferuar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ u konsultua me regjistrin themeltar dhe me regjistrin e arritjeve akademike. GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit dhe konstatoi plotësinë e tyre. Për këtë program studimi, GVJ konstatoi që numri i studentëve të regjistruar gjatë tre viteve të fundit akademike të raportuar në RVB përputhej me numrin e studentëve në regjistrin themeltar të plotësuar nga sekretaria mësimore.</p> <table border="1" data-bbox="612 864 1347 1149"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar për herë të parë</th> <th>Të transferuar</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>10 studentë</td> <td>-</td> <td>10 studentë</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>17 studentë</td> <td>-</td> <td>17 studentë</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>12 studentë</td> <td>-</td> <td>12 studentë</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ndërsa numri i të diplomuarve në këtë program studimi, (informacion i marrë gjatë vizitës në sekretari) është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për vitin 2019 – 9 studentë</li> <li>• për vitin 2020 – 6 studentë</li> <li>• për vitin 2021 – 10 studentë</li> <li>• për vitin 2022 – 6 studentë</li> </ul> <p><i>Tabelat Master Shkencor ISDRpdf.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>	Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali	2022-2023	10 studentë	-	10 studentë	2021-2022	17 studentë	-	17 studentë	2020-2021	12 studentë	-	12 studentë
Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali														
2022-2023	10 studentë	-	10 studentë														
2021-2022	17 studentë	-	17 studentë														
2020-2021	12 studentë	-	12 studentë														
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të gjitha të dhënat statistikore të studentëve (numri i matrikullimit, nota mesatare në hyrje dhe në dalje, vlerësimi i arritjeve të studentëve dhe të dhëna të tjera personale) ruhen dhe menaxhohen në sistemin e brendshëm të informacionit në format elektronik dhe në formë të dokumentuar nga sekretaria mësimore dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, e cila i vë në dispozicion të personave të autorizuar.</p> <p><i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarise Mesimore ne FB.pdf</i></p>																
	<i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i>																
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë</p>	<p>Sipas RVB kontolli i njësive përgjegjëse për menaxhimin e informacionit (Sekretaria Mësimore dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike) e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në bazë të rregulloreve</p>																

<p>mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>përkatëse dhe kuadrit rregullator në fuqi. <i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se dokumenti i paraqitur si rregullore e sekretarisë mësimore është në formën e draft-rregullores.</i></p> <p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe rregulloreve përkatëse Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit si njësitë përgjegjëse të programit të studimit, kanë për detyrë të dokumentojnë dhe vlerësojnë saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i>  <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i>  <i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarisë Mesimore në FB.pdf</i>  <i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti i Financë Kontabilitetit analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve (statistika bazuar në notën mesatare). Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së departamentit për vitin akademik, e cila mbyllet me problematikat dhe shoqërohet me rekomandime për përmirësime.</p> <p><i>Evidencë 128_Analiza e rregjistrimeve për programin Master Shkencor ISDR.pdf</i>  <i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UAMD mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve për programet e studimit.</li> <li>- Sistemi i brendshëm i informacionit i UAMD mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</li> <li>- Për vlerësimin dhe dokumentimin e saktësisë së informacionit që disponojnë njësitë përgjegjëse të menaxhimit të brendshëm të informacionit, UAMD bazohet në aktet rregullatore ku përcaktohet detyrat dhe përgjegjësitë e secilit.</li> <li>- Departamenti i Financë Kontabilitetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Studentore dhe Akademike analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td>Përmbushet plotësisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		



				X
--	--	--	--	---

### Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Rregullorja e UAMD (neni 115) përcakton të drejtën e studentëve për tu përfaqësuar në organet e UAMD dhe për të marrë pjesë në të gjitha proceset e vendimarrjes, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore.  <i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Sipas dokumentacionit shoqërues të RVB, GVJ konstaton se studentët përfaqësohen në Senatit Akadmik, Bordin e Administrimit (lajmërim për zgjedhjen e anëtarit të BA) dhe Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (tabela nr. 24), por konstaton se në rregulloret përkatëse nuk përcaktohet shprehimisht e drejta e përfaqësimit të studentëve në organe vendimmarrëse, përveç organizimit në këshilla studentorë.  <i>Evidencë 146_Shkresë_Për zgjedhjen e studentëve për anëtar Bordi.pdf tabelat Master Shkencor ISDRpdf.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit e tyre në të, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta realizohet nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen rregullisht nga studentët në fund të çdo semestri për të vlerësuar programin e studimit.  Në pyetësor studentët mund të komentojnë dhe japin sugjerime mbi lëndët dhe programet e studimit që ata ndjekin. Rezultatet e pyetësorëve janë objekt diskutimi dhe bëhen pjesë e analizës vjetore dhe planit të masave për përmirësim që ndërmerren duke filluar që nga departamenti.  <i>Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BsC MsC MP.pdf</i> <i>Evidencë 175 Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc ISDR.pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Neni 62 i rregullores së Fakultetit të Biznesit, parashikon të drejtën e studentit për të ankimuar rezultatin e provimit duke adresuar kërkesën e tij pranë drejtuesit të njësisë kryesore ku bën pjesë studenti jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i njësisë kryesore kur e sheh të arsyeshme i kalon për shqyrtim kërkesën drejtuesit të departamentit përkatës. Drejtuesi i departamentit, i cili vë në dijeni dhe personelin akademik të lëndës pas shqyrtimit të kërkesës dërgon te drejtuesi i njësisë kryesore një relacion shpjegues. Në bazë të relacionit drejtuesi i njësisë kryesore vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës

	<p>së studentit. Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës. Rregullorja parashikon edhe afatet kur ngrihet komisioni dhe kur studenti merr përgjigjen përfundimtare të vlerësimit të tij.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>		
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UAMD ka mundur angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në NJSBC si edhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, si dhe organizimin e tyre në Këshilla Studentorë.</li> <li>- Opoionet dhe mendimet e studentëve merren edhe nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të cilësisë, si pyetësorët, nëpërmjet të cilit studentët bejnë vlerësimin e procesit akademik dhe personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin.</li> <li>- Rregullorja e Fakulteti të Biznesit, parashikon të drejtën e ankimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin në provim.</li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në shtyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>UAMD ka ngritur njësi të posaçme në shërbim të studentëve si Sekretaria Mësimore, Zyra e Financës, Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në bazë të rregulloreve përkatëse dhe në përputhje me statutin dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p><i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarise Mesimore ne FB.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me</p>	<p>Të gjitha zyrat e UAMD janë në shërbim dhe në funksion të studentëve, por Sekretaria Mësimore dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike informojnë dhe mbështesin studentët vazhdimisht gjatë ciklit të studimit.</p>

<p>procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sekretaria mësimore e ngritur në nivel njësie kryesore, ka si mision të saj funksionim, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik (neni nr.1 i rregullores së sekretarisë mësimore).</li> <li>• Drejtorja e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, asiston dhe këshillon studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre akademike dhe udhëve të karrierës që do të ndjekin.</li> <li>• Gjithashtu edhe Departamenti i Financë Kontabilitetit si njësi bazë përgjegjëse e programit të studimit është në shërbim të studentëve për çdo informacion që lidhet me veprimtarinë mësimore të tyre.</li> </ul> <p><i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i>  <i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarisë Mësimore ne FB.pdf</i>  <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrirës, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike ka për qëllim ndërtimin e marrëdhënieve me studentë, Alumni, punëdhënës dhe institucione për të lehtësuar praktika studentore, punësim dhe mundësi karriere. Ky sektor midis detyrave të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ofron këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve në UAMD.</li> <li>• organizon dhe koordinon aktivitetet për studentët të tilla si: trajnime, seminare, konferenca studentore, orë leksioni të hapura nga lektorë të ftuar, promovim të aftësive të studentëve si në letërsi, pikturë etj.</li> <li>• mban kontakte dhe grumbullon informacione mbi punësimin e Alumnit;</li> <li>• harton Guidën Studentore, Materialet udhëzuese për maturantët etj.;</li> <li>• harton dhe raporton në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve aktualë, studentëve të diplomuar etj.</li> </ul> <p><i>Evidencë 39_Alumni Netëork FB Raport.pdf</i>  <i>Evidencë 134_Komunikim me emaile per praktika pune_Banka Intesa San Paolo.pdf</i>  <i>Evidencë 136_Panairi i Punes Njoftime.pdf</i>  <i>Evidencë 137_Komunikim me emaile per praktika pune.pdf</i>  <i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i>  <i>Evidencë 198_Njoftim punësimi për studentët.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit,</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrirës ndjek studentët e diplomuar në tregun e punës. Ajo mbledh të dhënat për të diplomuarit mbi shkallën</p>

<p>mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>dhe cilësinë e punësimit, ndjek integrimin e tyre në tregun e punës dhe mban kontakte me studentët e diplomuar me qëllim bashkëpunimin për interesa të përbashkëta. Ajo përpilon statistika lidhur përqindjen e studentëve të punësuar në çdo program studimi.</p> <p><i>Evidencë 127_Alumni Netëork_Pyetësor.pdf</i> <i>Evidencë 106_Raporti i vleresimi te brendshem FB 2018-2019.pdf</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>UAMD ka ngritur disa struktura si Sekretaria Mësimore, Zyra e Financës, Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike etj. në shërbim të nevojave të studentëve.</i></li> <li>- <i>Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrirës i cila ofron informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale dhe orientimin në tregun e punës.</i></li> <li>- <i>Zyra e Karrirës ndjek studentët pas diplomimit dhe mbledh dhe ruan të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve.</i></li> </ul>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	-----------------------------	-----------------------------	--

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p><b>Standardi VI.1</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bazuar edhe në dokumentacionin bashkëngjitur RVB, GVJ konstaton se institucioni angazhohet vazhdimisht në zhvillimin e mekanizmave dhe metodave inovative të mësimdhënies në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Plani strategjik përcakton si një objektiv të rëndësishëm nxitjen dhe favorizimin e metodologjive të reja dhe mësimdhënien inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin</p>

	<p>kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e dialogut student-pedagog.</p> <p>Sipas rregullores së programit të studimit (neni nr. 12), puna mësimore brenda këtij programi studimi zhvillohet konform formave të mësimin dhe të kontrollit të dijeve të përshkruara në rregulloret e brendshme të UAMD, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, si leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, punët laboratorike, detyrat e projektet e kursit etj.</p> <p>Në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion, ata konfirmuan përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies nga pedagogët në përputhje me parashikimet e syllabuseve të lëndëve si prezantime me poërpoin, prezantimi i rasteve studimore, ndarja në grupe pune etj.</p> <p>Institucioni angazhohet në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies si për trajnimin e stafit për mësimin online, apo përdorimit të metodave të testimit cleanscore etj.</p> <p><i>Evidencë 11_Plani Strategjik, Fakulteti i Biznesit, 2021-2025.pdf</i>  <i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut.pdf</i>  <i>Evidencë 168_Njoftim_Trajnim për mësimin online.pdf</i>  <i>Evidencë 169_Email Njoftim Clean Score dixhitalizimit të procesit të zhvillimit të provimeve.pdf</i>  <i>Evidencë 170_Trajnim për Clean Score 2018-2019.pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet nga bashkëpunimi mes strukturave si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC);</li> <li>- Zv/Rektori për Mësimin;</li> <li>- Drejtuesi i Departamentit të Financë Kontabilitetit, i cili është përgjegjës për programin e studimit.</li> </ul> <p>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, formularët e vetvlerësimit, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i>  <i>Evidencë shtesë: Analiza Ecurise- Msc. ISDR.pdf.pdf</i>  <i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ vlerëson se kuadri rregullator i UAMD u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga Drejtoria Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë, në nivel institucioni.</p> <p>Gjithashtu, rregullorja e UAMD (neni 120) dhe rregullorja e Fakultetit të Biznesit (neni 62) parashikojnë të drejtën e ankimit për të gjithë</p>

	<p>studentët lidhur me procesin mësimor dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, kundrejt plotësimit të një formulari pranë sekretarisë mësimore që i drejtohet Dekanit të fakultetit sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i>  <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Drejtuesi i departamentit i komunikon individualisht secilit anëtar të stafit akademik rezultatin e vlerësimit.</p> <p>Në përputhje me parashikimet në rregulloren përkatëse, Drejtoria e Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë përgatit raportin vjetor që vlerëson cilësinë e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në nivel të brendshëm, sipas kërkesave ligjore dhe nënligjore dhe ja përcjell për shqyrtim dhe miratim NjSBC-së, i cili i propozohet Senatit Akademik për miratim nga KPGS. Këto raporte bëhen pjesë edhe e analizave vjetore që realizohen në nivel departamenti dhe fakulteti.</p> <p><i>Evidencë 107_Rezultatet e vlerësimeve të lektorëve nga studentët për Departamentin e F-K 2017 -2018.pdf</i>  <i>Evidencë shtesë: Mbi raportimin periodik per zhvillimin e mesimdhënies ne klasat virtuale.pdf</i>  <i>Evidencë shtesë: Mbi realizimin e mesimdhënies ne klasat virtuale Google Classroom.pdf</i>  <i>Evidencë 106 Raporti i vleresimi te brendshem FB 2018-2019.pdf</i>  <i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi gadishmërinë e drejtuesve të institucionit për të promovuar personelin akademik dhe për të asistuar në drejtim të kualifikimit të mëtejshëm nëpërmjet ofrimit të trajnimeve brenda dhe jashtë vendit dhe pjesëmarrjes në konferenca dhe projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>UAMD ka hartuar politika dhe udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie.</i></li> <li>- <i>Kuadri rregullator i UAMD u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje.</i></li> <li>- <i>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, formularët e vetvlerësimit të stafit akademik, rezultatet e të cilëve përfshihen në analizat vjetore të realizuara në nivel departamenti, fakulteti dhe institucioni.</i></li> <li>- <i>UAMD angazhohet për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</i></li> </ul>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Neni 77 i statutit të UAMD përcakton që institucioni harton politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Nëpërmjet sigurimit të brendshëm të cilësisë kryhet vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të institucionit.</p> <p>Rrjeti i sigurimit të cilësisë sigurohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Strukturat hirearkike organizative të brendshme të UAMD, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij;</li> <li>• Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</li> <li>• Komisionin e Përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së institucionit.</li> </ul> <p>Në mënyrë më të detajuar, rregullorja e sigurimit të cilësisë parashikon strukturat e mëposhtme për sigurimin e brendshëm të cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në nivel institucional, Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), Koordinatorin Institucional pranë ASCAL (KIAL), Drejtorin e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC);</li> <li>• Në nivel fakulteti, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti), Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për çdo program, koordinatorët e programeve.</li> </ul> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i>  <i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i>  <i>Evidencë 164_Raportim lektore Mbi sigurimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë.pdf</i>  <i>Evidencë 91_Raportim lektore mbi sigurimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar në strategjinë e institucionit, UAMD është i përkushtuar për të siguruar cilësi dhe kërkon të promovojë kulturën e vëmendjes ndaj cilësisë midis studentëve, stafit akademik dhe atij administrative.</p> <p>Misioni kryesor i NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira në systemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Sipas rregullores së sigurimit të brendshëm të cilësisë, NjSBC ngrihet me urdhër të rektorit dhe ka shtatë anëtarë, nga të cilët, një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD-së, drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, si dhe një student.</p> <p><i>Evidencë 4_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025.pdf</i>  <i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i>  <i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i>  <i>Evidencë nr. 1.7 Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë.pdf</i>  <i>tabelat Master Shkencor ISDR.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UAMD ka kryer procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit institucional të zhvilluar nga ASCAL. UAMD është akredituar në vitin 2016 për herë të parë, për katër vite akademike dhe në vitin 2022 për herë të dytë me vendim të Bordit të Akreditimit nr. 18, datë 24.03.2022 me vlerësim pozitiv dhe kohëzgjatje 4vite, me afat vlefshmërie deri në 23.03.2026. Programi i studimit po i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit.</p> <p>Programi i studimit është licensuar me urdhër të Ministrit përgjegjës për arsimin e lartë, Nr. 282 datë 04.07.2013. Ky program studimi është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë. Përshtatja e programit është miratuar me vendim senati Nr. 112, datë 14.06.2018 dhe miratuar nga MAS me shkresën me Nr. Prot. 7243/1, datë 22.08.2018. Në vitin akademik 2022-2023 programi është riorganizuar deri në 20% me vendim senati Nr. 34, datë 28.03.2022.</p> <p><i>Evidencë 133_Vendim Nr. 10 datë 07.04.2017 Për Akreditimin e Parë të IAL Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i>  <i>Evidencë 192_Vendim Nr.18, datë 24.03.2022 i Bordit të Akreditimit.pdf</i>  <i>Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 49.2_Riorganizim Master nën 20%, 2021-2022.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 49_Riorganizimi Master FB_2021, Vendim Senati.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR v.a 2018-2019.pdf.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për</p>	<p>Bazuar në rregulloren e sigurimit të cilësisë (Aneksi II), sigurimi i cilësisë matet përmes të dhënave dhe treguesve të ndryshëm cilësorë dhe sasiorë të cilët analizohen dhe rishikohen nga stukturat e brendshme të sigurimit të</p>



<p>pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>cilësisë në shumë nivele dhe bëhen objekt diskutimi i analizës vjetore në vilët njësie bazë, kryesore dhe institucioni.</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni në bazë të parashikimeve ligjore dhe akteve rregullatore ka ngritur dhe ka në funksion strukturat për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucioni dhe njësie kryesore, përkatësisht DKSC dhe NJSBC, duke përcaktuar qartë në rregulloren përkatëse detyrat dhe përgjegjësitë e secilës prej tyre.</i></li> <li>- <i>Aktet rregullatore përcaktojnë procedurat, instrumentet dhe indikatorët e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i></li> </ul>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="549 887 767 958">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="767 887 971 958">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="971 887 1179 958">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="549 958 767 999"></td> <td data-bbox="767 958 971 999"></td> <td data-bbox="971 958 1179 999" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			<b>X</b>
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		<b>X</b>					

<p><b>Standardi VI.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e sigurimit të cilësisë të UAMD, përcakton qartë proceset dhe mekanizmat që përdoren nga institucioni me qëllim akreditimin. Pas dorëzimit të kërkesës së bashku me formularin për akreditim pranë Ascal, nis procesi i vlerësimit të brendshëm si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm i cili ngrihet nga titullari i njësisë;</li> <li>• Trainimi i GVB nga stafi i ASCAL; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit;</li> <li>• Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzuesve. Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe asistohet nga kjo e fundit në rast kërkesë;</li> <li>• Përgatitja e Dosjes së Vetëvlerësimit;</li> <li>• Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) sipas kërkesave e udhëzimeve dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me stafin e njësisë;</li> <li>• Dorëzimi në ASCAL i RVB, (në rastin kur ky proces kryhet si pjesë e vlerësimit dhe akreditimit periodik).</li> </ul>

	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se UAMD përdor mekanizma e procese të dokumentuara për shqyrtimin, vlerësimin, miratimin periodik të programeve të studimit.</p> <p>Programi i studimit është riorganizuar në vitin akademik 2018-2019, me qëllim përshtatjen më mirë të kërkesave ndaj tregut të punës duke ofruar kurrikula bashkëkohorë. Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë ka për detyrë rishikimin periodik të programit të studimit duke specifikuar edhe elementët të cilëve duhet ti kushtohet vëmendje gjatë procesit të rishikimit. Në këtë proces përfshihen edhe studentët nëpërmjet marrjes së opinionëve të tyre lidhur me zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>Dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, përbëhet vetëm nga një raport shumë i gjerë i vitit 2019-2019 dhe GVJ nuk mund të konstatojë nëse këto raporte gjenerohen në mënyrë periodike, pavarësisht se në rregullore kërkohet një raportim periodik.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.7 Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë.pdf</i>  <i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në mbledhjet e departamentit në fund të çdo viti mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të UAMD sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës.</p> <p>Raporti vjetor i vlerësimit të brendshëm përcakton qartë objektivat dhe metodologjia e përgatitjes së tij dhe analizohen në nivel universiteti ecuria e vitit akademik lidhur me programet e studimit, procesin mësimor, stafin akademik, studentët, menaxhimin dhe infrastrukturën e UAMD. Ky raport përmban informacion sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, të cilësisë të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Raporti shoqërohet me një analizë SWOT për çdo program studimit, përfshirë edhe këtë program</p> <p><i>GVJ konstaton se struktura e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm që kërkohet nga rregullorja e sistemit të sigurimit të cilësisë është e njëjtë me strukturën e raportit të vlerësimit të përdorur para disa viteve. Për këtë arsye rekomandon rregullimin e Aneksit I të rregullores duke e përshtatur sipas formatit aktual të raportimit të brendshëm të cilësisë.</i></p>

	<p><i>Gjithashtu raporti i vlerësimit të brendshëm duhet të realizohet çdo vit. Raporti që është pjesë e dokumentacionit të RVB i referohet vitit 2018-2019. Dokumentacioni shoqërues i RVB përmban disa dokumente të emërtuara analiza vjetore, raporte vlerësimi apo raporte vjetore, qëllimi i të cilëve duket i njëjtë por nuk kanë të njëjtën strukturë. Në këto raporte/analiza bëhet një përshkrim i punës së fakultetit/departamenteve dhe programeve të studimit. GVJ sugjeron që të evidentohen konkretisht problematikat e ndeshura gjatë vitit akademik dhe që kanë rezultuar nga zbatimi i instrumenteve të sigurimit të cilësisë dhe të shoqërohen me rekomandime dhe plan masash konkrete për trajtimin e mangësive dhe përmirësim të mëtejshëm.</i></p> <p><i>Evidencë 106_Raporti i vleresimi te brendshem FB 2018-2019.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Rregullorja e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë parashikon instrumenta të ndryshëm për sigurimin e cilësisë në drejtim mësimdhënies, shërbimeve që ofron institucioni, cilësisë së programeve të studimit, cilësisë së sudentëve, të personelit dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>Bazuar në rregullore, por edhe në Raportin vjetor 2018-2019, GVJ konstaton se institucioni studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit. Dekani i Fakultetit të Biznesit si autoriteti më i lartë drejtues, ushtron kontroll rreth veprimtarisë administrative, akademike dhe shkencore në të gjitha njësitë e fakultetit. Kështu, secili departamentet më në krye përgjegjësit respektivë, ushtron kontrole periodike për ecurinë e procesit mësimor. Angazhimet në ndjekjen e një leksioni të hapur nga lektorët, rishikimi periodik i literaturës së përdorur, shkëmbimi i eksperiencave jashtë auditorit dhe bashkëpunimin për ndërthurjen e lëndëve mësimore janë praktika promovuese ndaj shkëmbimit të eksperiencave të punës ndarmjet lektoreve dhe specialistëve të spikatur te fushave. Secili prej tyre informohet nga të gjithë anëtarët e departamentit rreth veprimtarive që kryejnë ata, nëpërmjet dodjeve të vetvlerësimit, si dhe ushtron kontroll rreth kësaj veprimtarie. Më pas, në mbledhjen e rradhës të secilit departament, bëhen të njohura rezultatet e kontrollit. Të gjitha këto forma të kontrollit janë në kuadër të promovimit të mësimdhënies sa më cilësore dhe përmirësimit të marrëdhënieve studentë-pedagogë.</p> <p><i>Evidencë 106_Raporti i vleresimi te brendshem FB 2018-2019.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 161_Monitorim i procesit mësimor.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 162_Njoftim për plotësimin e dosjes së vetëvlerësimit Njësia Bazë Njësia Kryesore.pdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit të Financë Kontabilitetit.pdf</i>  <i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, institucioni realizon sondazhe të studentëve nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen në fund të çdo semestri akademik nga studentët aktualë si dhe gjurmimin e studentëve të diplomuar nëpërmjet pyetësorëve ose intervistave që zhvillohen gjatë panairit të punës.</p> <p>Pyetësor i studentit vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Rezultatet e vlerësimit bëhen transparentë dhe i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamentit, si dhe dekanit nga DKSC në Rektorat.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve të institucionit (UAMD) sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentëve, pyetësorit të stafit akademik, pyetësorit të stafit administrativ, vlerësimit të drejtuesit të njësisë kryesore për stafin administrativ që ai drejton.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacion GJV konstatoi se përpunimi dhe analiza e pyetësorëve bëhej në nivel fakultetit. GJV sugjeron që vlerësimi të bëhet individualisht për çdo program studimi në mënyrë që të nxirren përfundime konkrete dhe specifike për programin e studimit.</i></p> <p><i>Evidencë 106_Raporti i vlerësimit të brendshëm FB 2018-2019.pdf</i>  <i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i>  <i>Evidencë 131_Pyetësor mbi rezultatet e anketimit të studentëve, të stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin, v.a 2017-2018.pdf</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GJV konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni përdor mekanizma dhe procese formale për monitorimin dhe vlerësimin e programeve të studimit, por GJV nuk konstaton që rezultatet nuk raportohen specifikisht për programin e studimit dhe analizat/raportet vjetore kanë më shumë trajtë përshkrimi të veprimtarisë vjetore të njësisë kryesore/bazë.</i></li> <li>- <i>GJV konstaton se rezultatet e vlerësimeve bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe merren në konsideratë për adresimin e problematikave të evidentuara, planin e masave për përmirësim dhe motivimin e praktikave më të mira.</i></li> </ul>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka ngritur struktura në nivel institucioni dhe njësi kryesore të cilat kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë duke përfshirë personelin e brendshëm akademik dhe administrativ, studentët si dhe aktorë të jashtëm si lektorë të ftuar apo bashkëpunëtorë në projekte të ndryshme, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Rregullorja e sigurimit të cilësisë përcakton ngritjen e strukturave të posaçme të sigurimit të cilësisë si: Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC), Njësina e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në nivel institucioni dhe njësi kryesore, Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL), Drejtorja e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC).</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Statuti (kreu VII), rregullorja e sigurimit të cilësisë (nenet 10, 11 dhe 12) përcakton strukturat përgjegjëse për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë të programit të studimit si dhe të gjitha organet, duke specifikuar detyrat dhe përgjegjësitë për secilin prej tyre.</p> <p>Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë.</p> <p>GVJ konstaton se studentët janë të përfaqësuar në NJSBC si edhe si anëtar të GVB së programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe</p>	<p>Fakulteti i Biznesit ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila ka për detyrë të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore.</p> <p>Në nivel fakulteti përgjegjës për sigurimin e standardeve të cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve;</li> <li>• Grupi i Vlerësimin të Brendshëm për çdo program;</li> <li>• Koordinatorët e Programeve.</li> </ul> <p>NjBSC në nivel fakulteti, realizon në mënyrë autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NjBSC në nivel Institucional. Për realizimin e objektiveve të akreditimit NjBSC në nivel Fakulteti bashkëpunon me</p>

<p>studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga NjBSC në nivel institucional.</p> <p>I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë, përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me strukturat përgjegjëse të sigurimit të cilësisë.</p> <p>GVB e programit të studimit përbëhet nga pesë anëtarë: tre staf akademik i departamentit të Financë Kontabilitetit, një staf administrativ dhe një student.</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB dhe gjatë takimit me drejtuesit e institucionit dhe stafin akademik përgjegjës të programit të studimit, GVJ konstatoi se personeli akademik përfshihet në mënyrë aktive në proceset e vlerësimit të programeve të studimit, duke respektuar të drejtat dhe integritetin akademik të secilit prej tyre dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me aktorë biznesi dhe institucione publike dhe private të cilat mundësojnë realizimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar, pjesëmarrjen e bizneseve të ndryshëm në panairët e punës, si dhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve.</p> <p>Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve, përfaqësues të biznesit apo institucioneve të tjera arsimore brenda dhe jashtë vendit, japin mendimet e tyre lidhur me cilësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e tij. Një nga instrumentet e përdorur nga departamenti i Financës për këtë qëllim është edhe pyetëtori që i dërgohet profesionistëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm për të shprehur opinionin e tyre lidhur me përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit të ofruara nga departamenti i financës.</p> <p><i>GVJ sugjeron që ky pyetësor të lidhet drejtpërdrejtë me përmbajtjen e programit të studimit dhe jo në tërësi me të gjithë programet e studimit të ofruar nga departamenti i Financë Kontabilitetit.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se strukturat e ngritura për sigurimin e brendshëm të cilësisë nuk kanë në përbërjen e tyre ekspert të jashtëm megjithatë pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Master i Shkencave "Industria e sigurimeve dhe Drejtimi i rrezikut" është një përfaqësues i biznesit.</i></p>

	<i>Vizita në Institucion</i>		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Aktet rregullatore lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë të UAMD, përcaktojnë qartë strukturat dhe njësitë që angazhohen në këtë proces.</i></li> <li>- <i>UAMD siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</i></li> <li>- <i>Përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm bëhet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme që organizohen nga institucioni, por ato nuk janë pjesë e strukturave formale të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i></li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në aktet rregullatore të institucionit si statuti i UAMD, plani strategjik dhe rregullorja e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, për të cilat studentët informohen vazhdimisht nga personeli akademik dhe strukturat e institucionit.</p> <p><i>Nga vëzhgimi i faqes zyrtare të institucionit, GVJ konstaton se kuadri rregullator i UAMD nuk është lehtësisht i aksesueshëm dhe një pjesë e dokumenteve/rregulloreve nuk janë të aksesueshme. GVJ sugjeron që faqja zyrtare e internetit e universitetit të plotësohet jo vetëm me kuadrin rregullator, por edhe me raportet vjetore të institucionit, në mënyrë që informacioni të jetë publik dhe i aksesueshëm nga studentët dhe të gjithë të interesuarit.</i></p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Master i Shkencave Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut.pdf.pdf</i>  <a href="https://www.uamd.edu.al">https://www.uamd.edu.al</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon	Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit analizohen gjatë analizave vjetore në Departamentin e Financë Kontabilitetit dhe bëhen

<p>rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>pjesë e Analizës së Veprimtarive Mësimore dhe Kërkimore të Fakultetit të Biznesit dhe sipas akteve rregullatore përfshihen në raportet periodike të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë në nivel rektorati.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se publikimet në faqen zyrtare web të UAMD dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet komunikimeve elektronike, shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes takimeve në ambjentet e institucionit, komunikimeve me e-mail dhe publikimeve në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p><i>Evidencë 10_Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UAMD.pdf</i>  <i>Evidencë 106_Raporti i vlerësimi të brendshëm FB 2018-2019.pdf</i>  <i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i>  <i>Evidencë 98_Analiza Vjetore e FB.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 112_Raporti vjetor UAMD për vitin akademik 2019-2020.pdf.pdf</i>  <a href="https://www.uamd.edu.al/fea">https://www.uamd.edu.al/fea</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstaton se rezultatet e vlerësimit u bëhen të njohura stafit akademik dhe sipas RVB merren në konsideratë për marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i evidencave dhe dokumentacionit shoqëruar të RVB, GVJ nuk konstaton hartimin e një plani masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p><i>Evidencë 107_Rezultatet e vlerësimeve të lektorëve nga studentët për Departamentin e F-K 2017 -2018.pdf</i> <i>Evidencë 98_Analiza Vjetore e FB.pdf</i>  <i>Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 112_Raporti vjetor UAMD për vitin akademik 2019-2020.pdf</i>  <a href="https://www.uamd.edu.al/fea">https://www.uamd.edu.al/fea</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në</p>	<p>Gjatë vizitës në insitucion GVJ iu konfirmua nga drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse të programit të studimit, në bazë të problematikave dhe ndryshimeve të kërkesave të tregut, angazhohen që të përmirësojnë programin e studimit në kuadër të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.</p> <p>Programi i studimit është riorganizuar në vitin 2018 për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë dhe përmbajtja e tij është</p>



vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>ndryshuar në vitin 2022 në një masë më të vogël se 20%, në mënyrë që të përshtatej më mirë me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20%, 2022-2023.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 49.2_Riorganizim Master nën 20%, 2021-2022.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 49_Riorganizimi Master FB_2021, Vendim Senati.pdf.pdf</i>  <i>Evidencë 51_Riorganizimi i MSC ISDR v.a 2018-2019.pdf</i>  <i>Vizita në Institucion</i></p>		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Referuar RVB dhe dokumentacionit në dispozicion, UAMD harton raportin vjetor mbi cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, i cili u vihet në dispozicion stafit akademik dhe administrativ. Gjithashtu drejtuesit e institucionit dhe strukturave përgjegjëse zhvillojnë vazhdimisht takime me personelin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 106_Raporti i vleresimi te brendshem FB 2018-2019.pdf</i>  <i>Evidencë 112_Raporti vjetor UAMD për vitin akademik 2019-2020.pdf</i></p>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Strategjia, politikat dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe të aksesueshme nga studentët dhe palët e interesuara.</i></li> <li>- <i>Informacioni i publikuar në faqen zyrtare të internetit, përfshirë edhe raportet vjetore, nuk është gjithmonë dhe qartësisht i aksesueshëm.</i></li> <li>- <i>Rezultatet e vlerësimit analizohen në mbledhje periodike në nivel njësie bazë, kryesore dhe në nivel institucioni, të cilat merren në konsideratë për përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i></li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>			
			X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave  
“Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut”, ofruar nga institucioni i arsimit të lartë  
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Infrastruktura që ofron institucioni në shërbim të programit të studimit është e përshatshme dhe me mjedise të pajisura me mjetet dhe teknologjinë e nevojshme për të garantuar cilësinë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
2. Stafit akademik i angazhuar në programin e studimit ka fushë kërkimore në përputhje me natyrën dhe veçoritë e lëndëve të ofruara në këtë program studimi.
3. Institucioni ka lidhur një numër të madh marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, institucione të tjera private dhe publike, që mundësojnë bashkëveprimin e institucionit me tregun e punës dhe kryerjen e praktikave profesionale.
4. Institucioni angazhohet në nxitjen e stafit akademik dhe studentëve për të marrë pjesë në mobilitete dhe projekte kërkimore dhe shkencore.
5. Institucioni organizon vazhdimisht aktivitete/konferenca shkencore në të cilat angazhohen stafit akademik dhe studentë të programeve të ndryshme të studimit të ofruar nga UAMD.

**Pika të dobta**

1. Një pjesë e akteve rregullatore të përfshira në dokumentacionin e RVB nuk janë të miratuara, të vulosura dhe të nënshkruara. Një pjesë e tyre janë në formën e draft-rregulloreve, ku data dhe nr. i vendimit të miratimit mungojnë (përfshirë këtu edhe rregulloren e programit të studimit).
2. Nga shqyrtimi i analizës financiare që ka bërë departamenti i Financë Kontabilitetit, ka parashikuar 40 studentë për programin e studimit. Në fakt gjatë tre viteve të fundit akademikë, numri i studentëve ka qenë më pak se gjysma numrit të parashikuar, dhe për këtë arsye të ardhurat e realizuara nga ky program studimi nuk mund të mbulojnë koston përkatëse.
3. Në raportimin e planit mësimor në tabela të ndryshme dhe duke e ballafaquar me syllabuset ka paqartësi lidhur me lëndët që zhvillohen, nëse janë të detyrueshme apo me zgjedhje, në cilin semestër zhvillohen. Gjithashtu pavarësisht se ka lëndë që zhvillohen në laborator, orët laboratorike nuk pasqyrohen në planin mësimor.
4. Literatura e detyrueshme në disa raste nuk përputhet me emërtimin dhe përmbajtjen e lëndës, dhe përdoren tekste që nuk janë të viteve të fundit.
5. Informacioni i publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit nuk është i mirë organizuar dhe lehtësisht i aksesueshëm. Në pjesën më të madhe të rasteve, informacioni nuk është i aksesueshëm.
6. Vlerësimi i cilësisë është realizuar në nivel fakulteti/institucioni, por nuk kryhet vlerësim dhe analizë e cilësisë për programin e studimit.

## Rekomandime

1. Dokumentacioni që shoqëron RVB duhet të jetë më i saktë lidhur me informacionin që përmban dhe emërtimin e tyre, në mënyrë që mos ketë paqartësi/gabime veçawrisht midis planit mwsimor dhe syllabuseve.
2. Aktet rregullatore të institucionit duhet të miratohen nga strukturat drejtuese.
3. Institucioni duhet të përpiqet nëpërmjet politikave të marketingut që të rrisë numrin e studentëve të programit të studimit.
4. Të përditësohet literatura bazë, në mënyrë që të përshtatet më shumë me emërtimin e lëndëve që janë specifike në industrinë e sigurimeve.
5. Informacioni në faqen e internetit të jetë i aksesueshëm dhe në përputhje me emërtimin që ka rubrika përkatëse.
6. Vlerësimi i brendshëm i cilësisë të bëhet për çdo program studimi dhe në anallizat vjetore të evidentohen konkretisht problematikat e ndeshura gjatë vitit akademik dhe që kanë rezultuar nga zbatimi i instrumenteve të sigurimit të cilësisë dhe të shoqërohen me rekomandime dhe plan masash konkrete për trajtimin e mangësive dhe përmirësim të mëtejshëm.
7. Të angazhohen më shumë pedagogë të kategorisë “Profesor” dhe jo pedagogë me Msc, në përputhje me nivelin e këtij program studimi.
8. Të rritet mbështetja financiare e institucionit për kërkimin shkencor të pedagogëve dhe studentëve.



**Conclusions of the evaluation of the second cycle study program, Master of Science in “Insurance Industry and Risk Management” of the higher education institution University “Aleksandër Moisiu”, Durres.**

**Strengths and Affirmations:**

1. The infrastructure provided by the institution is suitable and with spaces equipped with the necessary facilities, tools and technology to guarantee quality in teaching and learning.
2. The academic staff engaged in the study program has a research profile in accordance with the content of the subjects offered in this study program.
3. The institution has concluded a large number of cooperation agreements with institutions of higher education, other private and public institutions, which enable the institution's interaction with the labor market and the execution of professional practices.
4. The institution engages in encouraging academic staff and students to participate in mobilities and research and scientific projects.
5. The institution constantly organizes scientific activities/conferences in which the academic staff and students of the various study programs offered by UAMD are engaged.

**Weaknesses:**

1. Some of the regulatory acts included in the IAR documentation are not approved, sealed and signed. Some of them are in the form of draft regulations, where the date and no. of the approval decision are missing (including the regulation of the study program).
2. There is a small number of students. Reviewing the financial analysis performed by the Department of Finance and Accounting, 40 students have been forecasted to be enrolled in the study program per year. In fact, during the last three academic years, the number of students has been less than half of the projected number, and therefore the income realized from this study program cannot cover the respective costs.
3. Comparing the Teaching Plan (curriculum) with the syllabuses, there is ambiguity regarding the subjects that are developed, whether they are compulsory or elective, in which semester they are developed. Also, despite the fact that there are subjects that take place in the laboratory, the laboratory hours are not reflected in the curriculum.
4. The basic literature in some cases does not match the name and content of the subject, and texts are used that are not from recent years.
5. The information published on the institution's official website is not well organized and easily accessible. In most cases, the information is not accessible or missing.
6. The quality evaluation is performed at the institution/faculty level, but there is no specific evaluation and analysis on the specific study program.

**Recommendations:**

1. The documentation supporting the IER should be more precise regarding the information it contains and their denomination, so that there are no ambiguities/mistakes, especially between the curriculum and the syllabuses.
2. The regulatory acts of the institution must be duly approved by the management structures.
3. The institution should make more efforts through marketing policies to increase the number of students of the study program.
4. The basic literature should be updated, so that it fits more with the content of subjects that are specific to the insurance industry.
5. The information on the website should be accessible and in accordance with the name of the relevant section.
6. The internal quality assessment to be done for each study program and the annual analyzes should include the problems encountered during the academic year and identified from the the quality evaluation process, and accompanied by recommendations and a plan of measures for the treatment of shortcomings and further improvement.
7. The number of lectures among the "Professor" category should be increased and no Msc lecture/assitant should be engaged, in accordance with the level of this study program.
8. The institution should increase the financial support for the scientific research of the proffesors and students.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përmbushen plotësisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen pjesësisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>		<b>X</b>		
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>			<b>X</b>	
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>